

**PERMBLEDHJE E RAPORTIT TE THELLUAR  
TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER  
AKTIVITETIN E  
“PRODHIMIT TE DIOKSIDIT TE SQUFURIT TE LENGET- SO<sub>2</sub>”  
PRONE E SHOQERISE “ELBAGAS” SHA, ISH-KOMBINATI  
METALURGJIK**

**NJESIA ADMINISTRATIVE BRADASHESH, BASHKIA ELBASAN**

Sipas shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, “Projekte që i nënshtronen procedurës së raportit të thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, ID 4.2 Prodhimi i kimikateve inorganike bazë (3) – Kapaciteti kufi për leje të Tipit A – Të gjitha instalimet - 500kg/orë Dioksid Squfuri.



Subjekti Studio “Elbasani”

Shoqëria : “ELBAGAS” SHA Ekspert Mjedisore

Bashkia Elbasan Ing. Lila Karaj

Ing. Agromjedisi Ervis Pervana

Ing . Yzeir Miraka



## PERMBAJTJA E LENDES

Hyrje.....

1.Informacion për qëllimin e VNM-së dhemetodikën e zbatuar

2.Përshkrimi i projektit:

3.Një përshkrim i analizimit të alternativave të mundshme për zbatimin e projektit ose komponentëve të veçanta të tij (si: aksesi rrugor, administrimi i mbetjeve dhe ujërave të ndotura, llojet e lëndëve djegëse, vendndodhja e projektit etj.), si dhe sqarimi i arsyeve kryesore për alternativën e propozuar, duke marrë parasysh ndikimet në mjedis të secilës alternativë, si dhe, në rast se ka, mendimet dhe sugjerimet e institucioneve përgjegjëse që mbulojnë fushën e zbatimit të projektit.....

4.Një përshkrim të gjendjes dhe vleraveekzistuese të mjedisit, që mund të ndikohen nga zbatimi i projektit të propozuar, duke përfshirë:

5.Një përshkrim të ndikimeve negative tërëndësishme të projektit të propozuar mbi mjedisin ku përfshihen:

6.Ndikimet në mjedisin ndërkuqitar të projektit(nëse ka të tilla).....

7.Ndikimet pozitive në mjedisin e zonës sëprojektit.....

8.Masat e propozuara për mbrojtjen e mjedisitnga secili ndikim negativ, të identifikuara në paragrafin 5, më sipër.....

9.Programin e monitorimit të ndikimeve nëmjedis gjatë zbatimit të projektit.....

10.Planin e menaxhimit dhe monitorimit tëmjedisit:.....

- Informacion për mënyrën e realizimit të konsultimit gjatë procesit të hartimit të raportit të thelluar të VNM-së dhe metodat e konsultimit, rezultatet përkatëse, kontaktet e personave dhe subjekteve që kanë marrë pjesë në këtë proces, mendimet që janë dhënë dhe arsyetimet se si janë adresuar ose jo në raportin e thelluar të VNM-së, përfshirë edhe kërkesat e mendimet e dhëna në dëgjesën publike.....



## Hyrje

Shoqëria "ELBAGAS" sh.a zhvillon aktivitetin e "Prodhimit të Gazit Sulfuror - SO<sub>2</sub> pranë Uzinës 12, ish Kombinatin Metalurgjik të Elbasanit. Ajoështë rregjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit meNIPT J73312221K, Njësia Administrative Bradashesh, Elbasan dhe është paisur me Leje Mjedisore nga MMAU me Nr. Identifikimi 118, date 9.3.2011.

Instalimi për Prodhimin e Gazit SO<sub>2</sub>është i pozicionuar në Njësinë Administrative Bradashesh, Uzina 12, ish Kombinati Metalurgjik, Elbasan.

"ELBAGAS" SH.A si shoqëri me aktivitet në fushën e veprimitarise së prodhimit të gazit SO<sub>2</sub>, ka investuar dhe disponon impiantet/makineritë e domosdoshme për zhvillim e proceseve kryesore në prodhimin e produktit përfundimtar.

Kërkesa për hartimin e Raportit paraprak të VNM është bërë nga Z. Luan Malo, Administrator i shoqërisë "ELBAGAS" SH.A. Elbasan, dhe përfshin të gjitha të dhënat e informacionet teknike të nevojshme për realizimin e procesit për "Prodhimin e Dioksidit të Squfurit të Lëngët -SO<sub>2</sub>", në përpunje me legjisacionin shqiptar. Kjo kërkesë është bërë pasi shoqëria kërkondryshim të kapacitetit prodhues nga **160 kg/orë** në **500kg/orë** Dioksid **Squfuri**.

Përshkrimi i veprimitarise dhe kapacitetit prodhues (përshkruaj sipas kollonës 1 dhe 2 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar, "Industria kimike (1)"është:

**ID 4.2 Prodhimi i kimikateve inorganike bazë (3) – Kapaciteti kufi për lejet e Tipit A – Të gjitha instalimet- 500kg/orë Dioksid Squfuri.**

Aktiviteti industrial do të realizohet në objektin e ndodhur në Zonën Kadastrale Nr. 3965, Pasuria Numër 905. Uzina 12, ish Kombinati Metalurgjik, Bradashesh, Elbasan.

### 1. Informacion për qëllimin e VNM-së dhe metodikën e zbatuar

#### a) Përshkrimi i qëllimit dhe objektivave të VNM-së

Raporti i V.N.M. së Thelluar është hartuar në përpunje me kërkesat e ligjeve mjedisore në fuqi dhe konkretisht Ligjit Nr.10440, datë 07.07.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar, Kreu II, "Për veprimitarinë që i nënshtronen Procedurës së Thelluar të VNM-së". Përshkrimi i veprimitarise dhe kapacitetit prodhues të aktivitetit industrial "Prodhimittë Dioksidit të Squfurit të Lëngët-SO<sub>2</sub>" i përket, sipas Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar, "Industrisë kimike (1)"**ID 4.2 Prodhimi i kimikateve inorganike bazë (3) – Kapaciteti kufi për lejet Tipit A – Të gjitha instalimet-500kg/orë Dioksid Squfuri.**

#### Qëllimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis është një proces sistematik për të përcaktuar dhe vlerësuar efektet apo ndikimet në mjedis të një veprimi apo projekti të caktuar. Në një situatë normale, ky proces aplikohet përpara se të merren vendimet dhe të fillojnë angazhimet për realizimin e projektit. Në çdo kohë, efektet sociale, kulturore dhe shëndetësore janë konsideruar si pjesë



integrale e VNM-së. Kujdes i veçantë i kushtohet praktikave të VNM-së për të parandaluar dhe minimizuar efektet e mundshme negative të veprimeve të ndërmarra.

#### Qëllimi i Vlerësimit të Ndkimit në Mjedisë :

- Të japë informacion për vendim-marrësit për pasojat mjedisore të veprimeve të Propozuaranë kryerjen e aktivitetit për "Prodhimin e Dioksidit të Sufurit të Lëngët SO<sub>2</sub>",
- Të promovojë zhvillimin miqësor dhe të qëndrueshëm me mjedisin duke identifikuar masat e duhura për përmiresimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis.

#### Objektivat e V.N.M.-së

Objektivat e V.N.M.-sëndahen në dy kategori. Qëllimi i parë, i drejtëpërdrejtë, është të informojë procesin e vendimarrjes duke identifikuar ndikimet e konsiderueshme potenciale në mjedis dhe rreziqet e përfitimet e projektit dhe zhvillimit të propozuar. Qëllimi përfundimtar, afatgjatë i V.N.M.-sështë të promovojë zhvillimin e qendrueshëm duke siguruar që propozimet e projektit nuk dëmtojnë burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mirëqenien, stilin e jetës dhe jetesën e komunitetit si dhe të njerëzve që lidhen apo varen nga aktiviteti për "Prodhimin e Dioksidit të Sufurit të Lëngët SO<sub>2</sub>".

Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Ndkimit në Mjedis i shërben analizës së veprimeve të ndikimit në mjedis të veprimtarisë së prodhimit industrial për "Prodhimin e Dioksidit të Sufurit të Lëngët SO<sub>2</sub>", sipas Plan Zhvillimit të Zonës dhe Plan – Biznesit të Shoqërisë "ELBAGAS" sh.a. Aktiviteti për shfrytëzimin e objektit do të realizohet me fondet e zhvilluesit dhe pronarit të truallit.

#### b) Përshkrim i përbledhur i kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin

Për kryerjen e aktivitetit industrial për "Prodhimin e Dioksidit të Sufurit të Lëngët SO<sub>2</sub>", teknologjinë e prodhimit, vendosjen e paisjeve prodhuese, shoqëria "ELBAGAS" sh.a. ështëmbështetur në ligjislacionin mjedisor të miratuar në Republikën e Shqipërisë dhe rregulloret e ndryshme për mjedisin që janë:

##### - Ligji Nr.10448, datë 14.07.2011, "Për Lejet e Mjedisit".

Ky ligj ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës. Përcakton detyrimet per Pajisjen me Leje Mjedisore të subjekteve fizike dhe juridike që kërkojnë të ushtrojnë një veprimitari që ka ndikime në mjedis. Kreu IV i këtij ligji "Leja për veprimitaritë që ndikojnë në mjedis" Nenet 35-48 përcaktojnë modalitetet e marrjes së Lejes Mjedisore. Në rastin konkret aktiviteti për "Prodhimin e Dioksidit të Sufurit të Lëngët SO<sub>2</sub>", ka nevojë të pajiset me Leje Mjedisore.

- Ligjin Nr.60/214, date 19.06.2014 "Per një ndryshim ne Ligjin Nr.10448, date 14.07.2011, "Per lejet e Mjedisit" te ndryshuar

- Ligji Nr.10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"

Ky ligj ka për qëllim të mbrojtës së mjedisin e shëndetin e njeriut dhe të sigurojë menaxhimin e duhur mjedisorë të mbetjeve nëpërmjet:

a) parandalimit e minimizimit të mbetjeve ose pakësimit të ndikimeve negative nga krijimi dhë menaxhimi i integruar i mbetjeve;



- b) përmirësimit të eficencës së përdorimit të tyre;
- c) pakësimit të ndikimeve negative të përgjithshme nga përdorimi i burimeve.

- **Ligji Nr.10431, datë 09.06.2011, ne nenin 26 te tij ”Për mbrojtjen e mjedisit”**

Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.Ky ligj përcakton parimet, kërkosat, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit në Republikën e Shqipërisë.

- **Ligji Nr.10 440, datë 07.07. 2011, “Për Vlerësimin e N dikimit në Mjedis”**

Ky ligj ka për qëllim të sigurojë:

a) një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim;

b)garantimin e një procesi të hapur vendimarrjeje, gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve negative në mjedis, në mënyrën dhe kohën e duhur; si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në të.

## KREU II

### PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

Neni 7

#### **Procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis**

1. Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij ligji, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkosat e kreut II të këtij ligji, përpresa dhënie së lejes përkatëse, nga autoriteti përgjegjës, për zhvillimin ose jo të projektit.

2. Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

**a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;**

**b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.**

3. Dokumenti bazë, ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit, mund të jetë:

**a) raporti paraprak i VNM-së, për projektet e shtojcës II;**

**b) raporti i thelluar i VNM-së, për projektet e shtojcës I.**

në rastin konkret studimi përfshihet në Shtojcën I, “Projekte që i nënshtrohen procedurës së raportit të thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”,)ID 4.2 Prodhim i kimikateve inorganike bazë (3) – Kapaciteti kufi për leje të Tipit A – Të gjitha instalimet- 500kg/orë Dioksid Squfuri.

- **VKM.Nr.686, date 29.07.2015 ”Per miratimin e rregullave e te perjegjesive e te afatave per zhvillimin e procedurës se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis(VNM) dhe procedurës se Transferimit te Vendimit te Deklarates Mjedisore”**

- Vendimi Nr.419, date 25.06.2014, ”Per miratimin e kerkosave te posaçme per shqyrtimin e kerkosave te tipit A, B dhe C, per transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne, leshimin e tyre nga QKB-ja”



**Ligji Nr. 9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të Mbetjeve të Ngurta”.**

Ky ligj synon mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit nga ndotja dhe dëmtimi prej mbetjeve të ngurta, nëpërmjet administrimit mjedisor të tyre në çdo fazë, përfshi krijimin, grumbullimin, ndarjen, ruajtjen, transportin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin, të cilat çojnë në pakësimin e mbetjeve dhe zvogëlimin e ndikimeve të tyre të rrezikshme e të dëmshme.

**Ligji Nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për Trajtimin Mjedisor të Ujërave të Ndotur”**

Ky ligj ka për qëllim të mbrojë mjedisin dhe shëndetin e njeriut nga ndikimet negative të ujërave të ndotura, duke përcaktuar rregullat e trajtimit mjedisor të tyre, si dhe detyrimet e shkarkuesve të ujërave të ndotura.

Objekt i zbatimit të këtij ligji janë:

- a) ujërat e ndotura urbane; b) ujërat e ndotura industriale, sipas degëve të veçanta të industrisë; c) ujërat nga kullimi i tokave bujqësore; ç) ujërat e ndotura të çdo lloji.

Në përputhje me kërkosat e këtij ligji, personat fizikë dhe juridike duhet të marrin masa që të ulin në vijimësi sasinë e ujërave të përdorura, që shkarkojnë në mjedisin pritës dhe të pakësojnë shkallën e ndotjes së ujërave që shkarkojnë, sidomos të ndotjeve me lëndë e mbetje të rrezikshme (shkronja a dhe b e pikës I të nenit 6).

- **Ligji Nr.9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”** Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e shëndetit dhe e mjedisit nga zhurmat, duke përcaktuar mënyrën e shmangies dhe masat për parandalimin, reduktimin dhe zhdukjen e efekteve të dëmshme të ekspozimit ndaj tyre, përfshirë bezdinë nga zhurma. Ligji zbatohet për zhurmën, ndaj së cilës njerëzit ekspozohen në mjedisin ku ndodhen (mjediset e zonave të banimit, institucionet e ndryshme, zonat me aktivitet social-ekonomi, mjedise urbane dhe parqet publike). Ligji nuk zbatohet për zhurmën e lëshuar brenda vendeve të punës.

Legjislacioni mjedisor është ndërtuar edhe për të mbrojtur dhe parandaluar komponentë të veçantë dhe të rëndësishëm të mjedisit. Kështu, ndër më specifikut mund të përmendim:

- Ligji Nr.9587, date 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”

-Ligji Nr. 8766, date 05.04.2001, “Të mbrojtjes ndaj zjarrit”.

-Ligji Nr. 9108, date 17.07.2003, “ Për substancat dhe preparatet kimike”.

-Ligji Nr.7819, date 27.04.1994, ”Për pronësinë industriale”.

-Ligji Nr.9290, date 07.10.2004, ”Për produktet e ndërtimit”.

- V.K.M. Nr. 435, date 12.09.2002, “Për normat e shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”.

- V.K.M. Nr. 249, date 24.04.2003, “Për dokumentacionin për Leje Mjedisore dhe të elementeve të Lejes Mjedisore”.

- VKM Nr. 268, date 24.04.2003,”Për çertifikimin e specialisteve, për V.N.M. dhe auditimin mjedisor”.

- V.K.M. Nr. 177, date 31.05.2005, “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngta dhe kriteret e zonimit të njediseve ujore pritëse”.

- *Udhëzimi* Nr.429, date 17.11.2009, i Ministrit të Mjedisit, “Për rregullat dhe procedurat për paisjen me leje mjedisi në kuadër të Qendrës Kombëtare të Liçensimit”.



- V.K.M.Nr.587, date 07.07.2010, "Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike".
- Udhëzimin Nr.8, date 27.11.2007, "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara.

### **Procedura e përgatjes së Raportit të Thelluar të V.N.M. në vlerësim**

Në shkojcën 1 dhe 2 II të Ligjit Nr.10 440, datë 07.07. 2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" gjendet e listuar dhe veprimtaria për vlerësim. Për këtë arsy, në zbatim të V.K.M. Nr.249, datë 24.04.2003 "Për Miratimin e Dokumentacionit për Leje Mjedisore dhe të Elementeve të Lejes Mjedisore", parashikohet dhe Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, i cili do të hartohet sipas procedurave të parashikuara në Ligjin Nr.10440, datë 07.07. 2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", dhe udhëzimeve të dala në zbatim të tij. Vlerësojmë se kjo veprimtari pajiset me Leje Mjedisore dhe do t'i nënshtrohet procedurës së Vlerësimit të Thelluar të Ndikimit në Mjedis, Kreu II-të, nen 7, Procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis për Raportin e Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

#### **- Autorët e hartimit të raportit të thelluar të VNM-së**

Autore për hartimin e Raportit të Thelluar të VNM-sështëIng. Lila Karaj dhe Ing. Gjeolog Yzeir Miraka të paisur me Çertifikatë për hartimin e Raporteve Mjedisore nga Ministria e Mjedisit Ato kryejnë këtë aktivitet që nga viti 2008 dhe kanë hartuar një sërë raportesh paraprake dhe të thelluara si për aktivitete prodhuese ashtu edhe për aktivitete të ndërtimit të objekteve dhe të infrastrukturave rrugore, lendifilleve, dhe Planeve rregulluese në bashkëpunim me ekspertë të tjera mjedisore.

#### **- Metodikat e zbatuara dhe mënyra e sigurimit të informacionit për hartimin e raportit të thelluar të VNM-së**

Metodika e përdorur për hartimin e VNM-së së Telluar për aktivitetin e "Prodhimit të Dioksidit të Squfurit të Lëngët- SO<sub>2</sub>", ka qenë;

- 1) Grumbullimi dhe përpunimi i informacionit për aktivitetin e prodhimit të SO<sub>2</sub>
- 2) Verifikimi në vend dhe fotografimi i aktivitetit dhe repartit të prodhimit
- 3) Analizimi i procesit të prodhimit dhe ndikimeve negative e positive të gjeneruara nga aktiviteti industrial
- 4) Propozimet dhe Masat mbrojtëse që duhet të merren nga shoqëria prodhuese për zvogëlimin dhe minimizimin e ndikimeve negative

Mënyra e sigurimit të informacioneve ka qenë ajo zyrtare si me njësinë Administrative Bradashesh dhe Bashkinë Elbasan ashtu edhe me shoqërinë prodhuese "ELBAGAS"sha për procesin teknologjik dhe masat e sigurisë në punë e masat mbrojtëse të mjedisit.

#### **- Konsultimet e realizuara gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së**

Gjatë hartimit të Raportit të Thelluar të VNM për aktivitetin për "Prodhimin e Dioksidit të Squfurit të Lëngët- SO<sub>2</sub>", eksperti eshtë konsultuar me specialistë të mjedisit pranë ARM Elbasan, me specialist të prodhimit të SO<sub>2</sub>të shoqërisë "ELBAGAS", me specialistë të industrisë kimike, me biologë, me inginerë mjedisë etj. Gjithashtu eshtë realizuar edhe konsltimi me publikun që u realizua me pjesmarrës nga pushteti lokal, përfaqësues të ARM Elbasan, përfaqësues të biznesit në territorin e ish Kombinatit Metalurgjik, punonjës të shoqërisë prodhuese "ELBAGAS" sha etj.



**- Një përshkrim të vështirësive (mangësive teknike ose të njohurive) që zhvilluesi ka hasur gjatë hartimit të informacionit të kërkuar**

Gjatë punës për grumbullimin e informacioneve dhe të dhënave është hasur një sër vështirësish. Për zonën ku kryhet aktiviteti për "Prodhimin e Dioksidit të Sufurit të Lëngët-SO<sub>2</sub>", ka një sërë të dhënash për ndotjen e ajrit, tokës, ujit. Por azhornimi I tyre nuk ka qenë periodic, i përmuanjshëm për të bërë të mundur një vlerësim sa më real për ndikimin që do të ketë kjo zonë nga ndotjet që mund të shkatohen nga aktiviteti në fjalë. Matjet nga zhurmat janë të pakta në zonë ose pothuajse mungojnë fare. Gjithashtu nuk ka një të dhënë zyrtare mbi vdekjet dhe sëmundjet që janë shkaktuar nga aktivitetit dhe ndotjet në zonën e ish Kombinatit Metalurgjik, dhe këto të dhëna janë të përafshëta ose mungojnë. Megjithatë në bazë të konsultimeve me ekspertë dhe të dhënave të vëna në dispozicion nga pushteti lokal, Bashkia Elbasan është bërë e mundur që hartimi I këtij raporti të jetësa më i plotë dhe real.

**c) Përshkrim të metodikës së zbatuar për hartimin e raportit të thelluar të VNM-së:**

**Metodika.** Studimi i Vlerësimit të Ndjikitit në Mjedis u orientua nga volume i prodhimit industrial për "Prodhimin e Dioksidit të Sufurit të Lëngët- SO<sub>2</sub>", vendi ku ai prodhohet, pasuritë natyrore dhe humane të zonës si dhe vlerat e veçanta të tyre, identifikimi i ndikimeve negative dhe pozitive, marrja e masave zbutëse, duke patur parasysh edhe ruajtjen e interesave ekonomike të investitorit dhe masat orientuese për një zhvillim të qëndrueshëm të aktivitetit prodhues. Në këtë studim identifikohen ndikimet positive, negative në natyrë e në mjediset humane, dhe është marrë parasysh dhe vlerësimi i rrezikut. Reduktimi i ndikimeve negative është ndërthurur edhe me ndikime të rëndësishme pozitive, sidomos në kompësime indirekte mbi komunitetin. Studimi është kryer duke u ndarë në katër fazë kryesore:

1. Marrjes në konsideratë të çështjeve të mjedisit që në fazën e përgatitjes së propozimeve në projekt. Shqyrtimit të alternativave të ndryshme brenda projektit. Ngritja e objektivave orientuese të projekt-studimit.
2. Mbledhja e materialit bazë ekzistues dhe atij të formuluar për këtë projekt dhe seleksionimi e tij për përdorim; të japë një gjendje sa më reale nga pikëpamja e ndikimit të shrytëzimit të objektit dhe aktivitetit të prodhimit të SO<sub>2</sub> të Lëngët, mbi mjedisin human.
3. Analizimin e faktorëve pozitivë e negativë mjedisorë, dhënien e masave zbutëse për reduktimin e ndikimeve negative. Verifikimi në terren i të dhënave ekzistuese dhe mbledhja e të dhënave të mundëshme biosfizike dhe humane.
4. Nxjerrjes në dukje dhe vlerësimi cilësor me pika të ndikimeve në mjedis të aktivitetit për "Prodhimin e Dioksidit të Sufurit të Lëngët - SO<sub>2</sub>". Propozime të masave zbutëse të ndikimit në projekt. Hartimi i Raportit të Thelluar të VNM-së dhe dorëzimi tek porositësi, si dhe tek subjektet vendim-marrëse dhe kontrolluese të aspekteve mjedisore në nivele lokale.

**2. Përshkrimi i projektit**

**a) Përshkrimi i qëllimit të projektit të propozuar**

Pasi u pa i gjithë materiali i vënë në dispozicion nga investitori, qëllimi i këtij aktiviteti është:



- Ruajtja e mjedisit dhe pamjes panoramike të zonës industriale në të cilën kryhet aktiviteti për prodhimin e kimikateve inorganike bazë.
- Rritja dhe zhvillimi i qëndrueshëm i zonës në fushën e industrisë së prodhimit të kimikateve inorganikebazë.


Qëllimi i këtij Raporti Paraprak të Vlerësimit në Mjedis të përgatitur për këtë subjekt është:

1. të identifikojë pasojat e mundëshme negative mjedisore që mund të krijohen gjatë shfrytëzimit të objektit dhe aktivitetit prodhues.
  2. të përcaktojë e rekomandojë masat teknike -organizative për zbutjen e anëve negative që mund të krijohen gjatë zhvillimit të aktivitetit.
- b) Planimetria e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen, në hartë topografike, sipërfaqja e tokës së kërkuar, kufijtë e sipërfaqes së tokës së kërkuar, të shoqëruar me koordinatat sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE, të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes së tokës që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti gjatë fazës së ndërtimit apo instalimit të pajisjeve

#### Vendndodhja e objektit të fabrikës

Sipërfaqja egodinës industriale ku do të realizohet aktiviteti për "Prodhimin e Dioksidit të Squfurit të Lëngët - SO<sub>2</sub>" ndodhet në ish Kombinatin Metalurgjik, pranë Uzinës 12, Njësia Administrative Bradashesh, Bashkia Elbasan, Rrethi Elbasan. Aktualisht objekti ka njësipërfaqe trualli prej 2184m<sup>2</sup>.

Foto Nr. 02 Pozicioni Rajonal i objektit "Prodhimi i Dioksidit të Squfurit të Lëngët - SO<sub>2</sub>".



Prona me një sipërfaqe totale prej 2184m<sup>2</sup> është rregjistruar në Zyrën Vendore të Rregjistrimit të Pasurive të Paluejtshme Elbasan si vijon: Zona kadastrale 3695 Nr. Pasurise 905; Indeksi hartës EL-H-8; I-8 me sipërfaqe trualli 2184 m<sup>2</sup>, me sipërfaqe ndërtese ekzistuese 594.75m<sup>2</sup>, me pronar të harruarin "ELBAGAS" sh.a.

Foto Fragmenti i Harts topografike e shkalës 1:10000, Nomenklatura (K-34-101-C-a-3)






Tabela Kufizimet e pronës

Veri	916/3; 827/2.
Lindje	827/2; 931.
Jug	931; 916/3.
Perëndim	916/3.

Foto Harta Treguese e Pasurisë sipas Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan



Foto Nr.03

## HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT (Fragment)

ZYRA E REGJISTRIMIT  
TE PASURIVE TE PALUAJTSHME  
ELBASAN

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE  
ZONA KADASTRALE 3963 NR.PASURISE 96 VOL. 4 FQ. 229  
INDEKSU I HARTES N. H-8, L-8 SHKALLA 1:1000  
ADRESA E PASURISE: RRETHI ELBASAN Q/F METALLURGI  
R/L. / MTTALURGI P/G SH\_K Ap\_

B. KUFIZIMET

V. 916/3,827/2  
L. 87/2,931  
J. 931,916/3  
P. 916/3


C. PRONARI

SHQQERIA TE RAGAS "SHA"



D. DATA 13/04/2012 ORA 10

Vula.




SUPERFAQJA E TRUAT IT -2184M  
SUPERFAQJA E KNDRTESES =594,75M

ING. D. CELA

Foto Planimetri i pasurisë së Strukturës për aktivitetin e "Prodhimit të Dioksidit të Sqafurit të Lëngut  $\text{SO}_2$ ".



## PLANI I VENDOSJES SE STRUKTURES



KRYETARI  
KOMUNES BRADASHESH

SABRI SOLLAKU

Drejtori D.P.K.Z.H.T.

Ing. Ylli Ago

TE DHENA TE PREGATITSHYE	
ENGJAMI I PUNEVE I BIRTE I KOI E CB. TE PRICHTA KJO REZERVOER ELOI I INTRVNDUREZ - MATERIJALE ME BOLLA TE PAVERDERJA SHKULLA 15.00 METRA TULIJA 20.00 PROJEKT I PREDRIESTOREZI 2014-2016 ADMIS. BEZ BREZIM. METALLURG. LUSIA 12 - ROMANA VYNOVSKI MODI I PERFORMANC KOMPANY	
TRENDZUEZ E DIZAJNU TE PROPOZUE	
KOMERCI KOMUNALI MASA KUPLA TRENQ D-1.00 MASA INTRVNDUREZ Z-2.00 MASA INTRVNDUREZ Y-1.00 L-1.00	
TENDZUEZ NE DIZAJN RIVIKELE BESHA DUARIE QELQ PARKU BESHA	
VJEZ PUNA VJEZ	
PROJEKT MAZAKA TIPICO MASA TURISTI SHKULLA 15.00 METRA TULIJA 20.00 PROJEKT JESTI I PREDRIESTOREZ VILAJ. UEL A SHKA ORUGA 2.00 METRA E DOLZIT TE PRODHIMI TE DOKSIDI TE KOFKUT TE LENDER PC	
POZICHI I PREDRIESTOREZ SHKULLA 15.00 METRA 20.00 RE BRADASHESH - ELASHKE	
NED F.A. ST. MIRE 20.00 PLANHODZUE 1. KOMBINACION PLATA UNI	

PROJEKT MAZAKA TIPICO MASA TURISTI SHKULLA 15.00 METRA TULIJA 20.00 PROJEKT JESTI I PREDRIESTOREZ VILAJ. UEL A SHKA ORUGA 2.00 METRA E DOLZIT TE PRODHIMI TE DOKSIDI TE KOFKUT TE LENDER PC	
POZICHI I PREDRIESTOREZ SHKULLA 15.00 METRA 20.00 RE BRADASHESH - ELASHKE	
NED F.A. ST. MIRE 20.00 PLANHODZUE 1. KOMBINACION PLATA UNI	

Foto Pamje ajrore e Pronës për aktivitetin “Prodhimi i Dioksidit të Squfurit të Lëngët SO<sub>2</sub>”



Koordinatat e kafshit të pronës dhe objektit për “Prodhimin e Dioksidit të Squfurit të Lëngët SO<sub>2</sub>” në projekcionin GAUS-KRYGER janë si më poshtë:

Tabeli KEMI Njëma e pronës së Shoqërisë



Pikat	X	Y
1	4418242.81	4550655.66
2	4418268.86	4550667.71
3	4418297.36	4550605.64
4	4418272.35	4550596.04
5	4418267.76	4550599.58

Foto Pamje ajrore e Depozitave të Gazit Sulfuror të Lëngët SO<sub>2</sub>



Tabela Koordinatat e depozitave të gazitSO<sub>2</sub>

Pikat	X	Y
1	4418262.60	4550611.31
2	4418281.51	4550619.63
3	4418286.54	4550605.88
4	4418274.65	4550600.51



Foto Pamje ajrore e objektit të Linjës së Prodhimit të Gazit Sulfuror të Lëngët SO<sub>2</sub>



Tabela Koordinatat e linjës së prodhimit

Pikat	X	Y
1	4418250.07	4550640.08
2	4418267.96	4550647.74
3	4418262.60	4550611.31
4	4418281.51	4550619.63

Foto Pamje ajrore e Depozitimit të Lëndës së Parë për Prodhimin e SO<sub>2</sub>




Tabela Depozitimi i lëndës së parë



Pikat	X	Y
1	4418273.47	4550636.34
2	4418281.17	4550639.17
3	4418287.34	4550626.30
4	4418279.75	4550622.91

### c) Skicat dhe planimetritë e objekteve të projektit dhe strukturave të projektit

Zona ka këto të dhëna urbanistike të cilat janë pasqyruar në Planvendosjen e Sheshit të Ndërtimit të godinës.

Godina industriale për “Prodhimin e Dioksidit të Sufurit të Lëngët - SO<sub>2</sub>”, është realizuar në pronën me Nr. 905, me sipërfaqe trualli 2184m<sup>2</sup> dhe me pronar shoqërinë “ELBAGAS”sh.a

Kondicionet urbanistike për këtë objekt janë:

- ↳ Sip. Trualli ..... 2184,00 m<sup>2</sup>
- ↳ Sip. Trualli e zënë nga strukturaekzistuese..... 838,95 m<sup>2</sup>
- ↳ Sip. Përgjithshme ndërtimi..... 838,95 m<sup>2</sup>
- ↳ Lartësia e katit përdhe..... 9,60 m
- ↳ Koeficienti i shfrytëzimit të truallit..... K=38,40 %
- ↳ Numuri i kateve nëntokë .....nuk ka
- ↳ Numuri i kateve mbi tokë .....dy
- ↳ Hyrja në parkim nga perëndimi

Foto Pamje perëndimore dhe lindore e objektit ku “Prodhohet Dioksid i Sufurit të Lëngët - SO<sub>2</sub>”



Foto Plani i Katit Përdhe të pjesës 2 kat të objektit








Foto Plani i Katit Parë për pjesën 2 kat të objektit



ç) Përshkrimi i proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese / përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit

#### Përshkrimi i procesit teknologjik

Kjo projekt përfshin të gjitha të dhënat e informacionet teknike të nevojshme për realizimin e tij si dha shiftejimin e objektit në përputhje me legjislatin shqiptar. Në përgjithësi objekti përban:



- Linjën e Prodhimit të SO<sub>2</sub>.
- Sistemin e Lëngëzimit të SO<sub>2</sub> (Kompresorët e SO<sub>2</sub>, këmbyesit e nxehësisë).
- Depozitat e SO<sub>2</sub> të lëngët, 4 rezervuare me volum gjemometrik të përgjithshëm prej 235 m<sup>3</sup>.
- Sektori i mbushjes së bombolave e fuçive të SO<sub>2</sub>, me dy poste mbushjeje, me zona të veçanta përvendosjen e bombolave e fuçive boshe dhe të plota.
- Sistemin e ujit ftohës dhe zjarrfikës, i përbërë nga pusi i ujit me pompën përkatëse, një depozitë uji me kapacitet 50 m<sup>3</sup>, pompa e ujit ftohës (dhe zjarrfikës).
- Sektorin e Kontrollit Teknik Periodik të bombolave e fuçive të SO<sub>2</sub>.
- Sektorët ndihmës si: zyra, dhoma e personelit, magazina, ofisina, kabina elektrike.

### Funksionimi dhe kapacitetet

Në objekt kryhen: prodhimi i SO<sub>2</sub> të lëngët, mbushja e bombolave e fuçive të SO<sub>2</sub> si dhe kontrolli teknik i bombolave e fuçive të SO<sub>2</sub>. Kapaciteti normal i prodhimit është rreth 500 kg SO<sub>2</sub>/orë, kapaciteti ruajtës/mbajtës i depozitave është rreth 290 Ton SO<sub>2</sub>; kapaciteti për mbushjen e bombolave e fuçive të SO<sub>2</sub> është rreth 1000 kg SO<sub>2</sub>/orë, kapaciteti për mbushjen e çisternave është rreth 5 Ton SO<sub>2</sub>/orë.

#### Kapacitetet prodhuese të instalimit.

Ky instalim ka një kapacitet prodhues rreth 4 ton/ditë të produktit përfundimtar. Ky kapacitet, ndër të tjera kushtëzohet edhe nga mungesa e tregut për këtë lloj produkti dhe konkurrenca e fortë në vend dhe rajon. Për çdo 1kg Gaz të prodhuar, konsumohet rreth 0.5-0.6kg Squfur lëndë e parëdhe rreth 1-1.2 kg Oksigjen. Instalimi ka një fuqi elektrike të instaluar prej rreth 100këh dhe konsumon rreth 1.6m<sup>3</sup>/ditë ujë industrial, i cili shërben vetëm për ftohjen e pajisjeve dhe larjen e ambienteve të punës. Nga eksperiencia e deri tanishme e këtij subjekti, është vërtetuar se ky aktivitet funksionon në bazë të porosive të konsumatorit të huaj dhe që përbën një periudhë maksimalisht 30% të vitit (pra rreth 4 muaj). Por vitet e fundit, nuk është arritur as një realizim i tillë, duke u reduktuar deri në 20% të periudhës sëviti (1-2 muaj).

Për prodhimin e gazit sulfuror (SO<sub>2</sub>) të lëngëzuar, përdoret procesi i oksidimit të squfurit me cilësi të lartë termike (i cili prodhohet në U.P.Th.N Ballsh), me oksigjen të pastër mbi 98.2%. Oksigjeni i nevojshëm furnizohet me anë të një linje që vjen nga fabrika e prodhimit të oksigjenit nga ish Kombinati Metalurgjik Elbasan, (aktualisht nën administrim nga Kurum Internaciona Sh.A)

Linja ka një gjatësi rreth 800-900m. Bioksiddi i Squfurit i përfshuar nga kjo linjë teknologjike, ambalazhohet në bombolat përkatëse të tipit "G" të cilat ruajnë materiale deri nën një presion 6kg/cm<sup>2</sup>. Këto bombola kanë karakteristikat fizike si më poshtë:

Tabela

Bombolat e gazit, tipi.	Ngjyra	Ngjyra e shkrimit	Ngjyra e shiritave nën shkrim
Tipi G	E Zezë	E bardhë	E Verdhë

#### Procesi i prodhimit të bioksidit të Squfurit (SO<sub>2</sub>)

Procesi i prodhimit të gazit sulfuror (SO<sub>2</sub>) të lëngëzuar bazohet në realizimin e disa stadeve të përpunimit të lëndëve të para, squfurit dhe oksigjenit. Nëpërmjet dhënies nga jashtë të energjisë termike, squfuri shndërrohet në squfur të shkrirë e më pas kemi oksidimin e squfurit të shkrirë e të sublimuar, në bioksid të squfurit të sublimuar në rrymën e oksigjenit të pastër sipas reakzionit  $SO_2 + O_2 = SO_2 + 70,9\text{kkal}$



Kjo nxehtësi e çliruar është e mjaftueshme për realizimin jo vetëm të procesit të mëtejshëm të oksidimit të squfurit por edhe për shkrirjen e squfurit.

Bioksid i squfurit i krjuar së bashku me një sasi squfuri të sublimuar shkrin në sublikator, ku kryhet ftohja për efekt zgjerimi. Këtu krijohet dhe ndahet sasia më e madhe e "lules së squfurit".

### Baza ligjore e projektit teknologjik

Projekti plotëson kërkesat e këtyre dokumenteve tekniko-ligjore:

- VKM Nr. 73, date 28.01.2008 "Për miratimin e rregullave teknikedhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve nën presion".
- "Kushtet teknike dhe normat e projektimit për impiantet dhe instalimet që shërbejnë për transportin, depozitim dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", miratuar me urdhër të Ministrit të Ekonomisë, Tregtise dhe Energjitetit.
- Normat italiane tëprojektit sipas DM date 13 oktobre 1994 –Approvazione della regola tecnica di prevencione encendi per la progettazione, la costruzione, l'installazione e l'esercizio dei depositi di "GPL" i serbatoi fissi di capacità complessiva superiore a 5 m<sup>3</sup> e/o i recipienti mobile di capacità complessiva superiore a 5000 kg.

### Produktet përfundimtare të projektit që do të zhvillohet.

Produkti përfundimtarështë Dioksidii Squfurit të Lëngët - SO<sub>2</sub>i futur nëpër bombola. Mbas kësaj, prodhimi është i gatshëm për t'u treguar sipas kontratave me blerësit.

d) Infrastruktura e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacion për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja

- Lidhja me rrjetin elektrik

Me rrjetin elektrik kemi lidhje në kabinën elektrike qështë vendosur në objekt nga OSHEE-ja e Elbasanit. Energjia elektrike: tensioni 10 KVA / 380V, frekuenca 50Hz.

- Furnizimi me ujë

Furnizimi me ujë të pijshëm bëhet me ujin e rrjetit të ujësjellësit që furnizon Njësinë Administrative Bradashesh dhe ish Kombinatin Metalurgjik. Aktiviteti zhvillohet në brendësi të Zonës Industriale të ish Kombinatit Metalurgjik, ku infrastruktura është e ngritur dhe ekzistuese. Linjat e furnizimit me ujë industrial janë të Kombinatit Metalurgjik dhe nuk janë ndërtuar të reja. Ky ujë, sipas deklarimeve të investitorit, është i pastër, nuk përzihet me asnjë komponent kimik, as lëndët e para, as produktin. Ai qarkullon në anën e jashtme të kondesatorëve. Uji ftohës merret nga linja e ujit industrial të ish Kombinatit Metalurgjik si dhe nga depozita e ujit qarkullues, me vëllim 50 m<sup>3</sup> ndërtuar nga shoqëria "ELBAGAS" sh.a. Sasia e ujit industrial që përdoret për ftohje është 20 m<sup>3</sup>/orë.

Shkarkimi i ujrate të ndotur



Procesi tekonologjik, nuk përfshin ujin dhe si rrjedhojë edhe nuk ka shkarkime të ujërave industriale. Ky lloj aktiviteti përdor ujin në proceset industriale vetëm për sistemin ftohës. Janëdy depozita ftohëse(kondesatorë) të cilët shndërrrojnë gazin në lëng.

Uji industrial që përdoret gjatë procesit teknollogjik për prodhimin Dioksidit të Squurit të Lëngët, SO<sub>2</sub>, në një cikël të caktuar, pasi përdoret për ftohje, shkarkohet në rrjetin e kanalizimeve të zonës së Kombinatit Metalurgjik, bashkë me ujrat e zeza, ku kalon në kolektorin kryesor të kombinatit para shkarkimit të tyre në mjeshtë e zonës. Objekti është i pajisur me kanalizime për ujërat higjeno-sanitare.

#### • Mbetjet e prodhua

Në procesin e prodhimit të SO<sub>2</sub>, sasitë më të mëdha të mbetjeve të gjeneruara janë substanca inerte. Meqenëse zona ku ndodhet objekti është në afersi të lumit Shkumbin, që përshkon qytetin e Elbasanit, duhet patur shumë kujdes në trajtimin dhe largimin e mbetjeve që krijohen nga procesi i prodhimit.

Mbetjet do të mbahen larg nga aksi i rrugës së brendëshme dhe veçanërisht nga kapanonet ekzistuese tëish Kombinatit Metalurgjik.

Mbetjet nuk duhet të qëndrojnë pranë sheshit të lëndës së parë dhe nuk duhet të qëndrojnë anash objektit të Linjës së Prodhimit të SO<sub>2</sub>, për të eleminuar çdo lloj ndotje të lëndës së parë për prodhimin e SO<sub>2</sub>, ujrate sipërsaqësorë ose bllokim të tyre nga mbeturinat e dherave si dhe ndotjen e rrugeve të kalimit nga balta

Mbetje të ngurta që mund të prodhohen janë ato të skorjeve që prodhon furra (trajtë gurësh). Këto mbetje, prodhohen nga papastërtitë që mund të ketë squfuri si lëndë e parë, që nuk ze më shumë se 1-2% të tij. Këto mbetje mund të jenë lloj qymyri dhe sasia e prodhimit të tyre për gjithë vitin, nga i cili punohet vetëm 1-2 muaj është rreth 40 kg.

Mbetjet e ngurta urbane, 3-5 kg/ditë, fillimi do të grumbullohen brenda territorit të objektit industrial, sipas plan -vendosjes së pikës së grumbullimit të mbetjeve urbane që është miratuar nga Bashkia Elbasan.

Sasia e gjenerimit të mbetjeve të specifikuar sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.99 datë 18.2.2005 të Këshillit te Ministrave "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve" janë si vijon:

Nga proceset për prodhimin e bioksidit të squurit nuk kemi gjenerim të mbetjeve të rrezikshme. Të gjitha operacionet e prodhimit të SO<sub>2</sub> janë të kontrolluara dhe brenda kufinjve të lejura për instalimet të tillë.

Mbetje të krijuara gjatë aktivitetit prodhues të SO<sub>2</sub>:

-	gurë - kod 20 02 02							
-	Mbejet	-	e	përziera	urbane	20	03	01



### **Trajtimi i mbetjeve.**

Këto mbetje duke qenë në trajtë të ngurta dhe të patretshme, nuk përbëjnë problem për kontenierin e mbetjeve të ngurta të Kombinatit Metalurgjik. Ato depozitohen për menaxhim së bashku me mbetjet e ngurta të llojeve të tjera të gjithë kombinatit. Këto mbetje duhet të menaxhohen duke u depozituar dhe sistemuar kundër ekspozimit ndaj efektit të erozionit dhe përhapjes së tyre në mjedis. Ato duhet të menaxhohen nga një subjekt i licensuar dhe që plotëson kriteret për menaxhimin e tyre.

Mbetjet e ngurta urbane që prodhohen nga personeli dhe punonjësit përbëjnë 3-5 kg/ditë dhe largohen nga Njësia Administrative Bradashesh sipas kontratës që ka shoqëria "ELBAGAS" sh.a me Bashkinë Elbasan.

**dh) Programi për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit**

- Kohëzgjatja e ndërtimit**

Objekti ku kryhet aktiviteti për "Prodhimin e Dioksidit të Sufurit të Lëngët, SO<sub>2</sub>" ka një kohëzgjatjemi 25 vjet dhe do të funksionojë për interes të shoqërisë "ELBAGAS" sh.a deri kur t'a shohë ajo të nevojshme.

- Kohëzgjatja e planifikuar për funksjonimin e projektit**

Objekti për Prodhimin e Dioksidit të Sufurit të Lëngët, SO<sub>2</sub> do të funksionojë deri në kohën dhe afatin e amortizimit për objekte me funksion industrial. Gjatë kësaj periudhe do të ketë ndërhyrje të herëpasherëshme për mirëmbajtje dhe meremetim nga ana e investitorit.

- Faza e planifikuar për reabilitimin e sipërfaqes pas mbarimit të projektit**

Mbas mbarimit të aktivitetit prodhues, investitori, shoqëria "ELBAGAS" sha.e cila është në aktivitet të vazhdueshëm për rehabilitimin e mjedisit të territorit ku është ndërtuar objekti industrial për realizimin e aktivitetit "Linjë e Prodhimit të Dioksidit të Lëngët dhe e mbushjes së bombolave e cisternave me SO<sub>2</sub>", do të marrë masat edhe pas mbarimit të funksionit të objektit.

Konstruksioni i objektit është i tillë që ai mund të përdoret edhe përfunksione të tjera industriale, nëse aktiviteti i mësipërm për arësyte të ndryshme, mund të ndërpitet. Aparaturat për prodhimin e SO<sub>2</sub> largohen nga reparti së bashku me bombolat e gazit dhe ambienti i repartit për nga mënyra e ndërtimit është i gatshëm të adoptohet për procese të ndryshme industriale.

- e) Mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve të projektit**

Këtoobjektejanë ndërtuar prej konstruksioni b/ame funksione të përcaktuara sipas aktivitetit prodhues, me hapsira të mëdha, tip kapanonesh të hapura. Lartësia e objektit është mbi 9 m e domosdoshme për të vendosur vinçurë që bën lëvizjen dhe transportin e bombolave dhe të materialit të parë prodhues. Mënyra e ndërtimit është ajo e kapanoneve industriale me hapësira të mëdha me kollona betonarme në formë T, me çati b/a me material të padjegshëm. I gjithë konstruksioni i objektit është b/a sit ë gjithë kapanonet e tjera të ish Kombinatit Metalurgjik, që është i lidhur me kanalizimet e ujrate të zeza ekzistuese dhe tubacionet e ujit industrial të tij.



**ë) lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyrën e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji)**

Materialet që janë përdorur për ndërtimin e godinës industriale për "Prodhimin e Dioksidit të Sfufurit të Lëngët - SO<sub>2</sub>" kanë qenë kryesisht të gatshme prej betoni, betonarmeje të cilat janë hedhur, vendosur ose montuar në objekt. Uji është marrë nga linjat e ujësjellësit në zonë. Ndërsa energjia elektrike nga tensjoni i ulët. Materialet janë të paisura me çertifikata të cilësisë së materialeve dhe janë kontrolluar para vendosjes në objekt. Materialet që përdoren për aktivitetin prodhues janë si më poshtë:

Tabela Të dhëna specifike për lëndët e para

	Po	Jo	Përshkruaj (tipin sasinë dhe burimin)
A përdorni lëndë të para ?	X		Lënda e parë prodhuese- sfufur i ngurtë që merret nga Uzina e Ballshit Material Ndihmës – Nitroglycerina ushqimore Oksigjeni – merret nga KME
A përdorni lëndë djegëse (dhe/ose energji)?	X		Tipi: energji elektrike ; Sasia: (12 orë në ditë) sipas proceseve të punës Burimi furnizimit: enti tregtar i energjisë elektrike OSHEE Elbasan
A përdorni kimikate sintetike/laboratorike?		X	Jo
Lutemi rendisni materialet sipas volumeve që përdorni			Objekti është ekzistues

**KONSUMI I ENERGJISE**

Burimi	Konsumi ditor dhe total në bazë viti këh/g; t/g dhe të ngjashme. Kabina elektrike pranë objektit
Energji elektrike	2680kë/ditë; (24 orë në ditë), kohën gjatë shfrytëzimit të objektit duke patur parasysh energjinë për vënien në punë të makinerive.

**KONSUMI UJIT**

Burimi furnizimit	Konsumi ditor dhe total në bazë viti (m <sup>3</sup> ) Sistemi magjistral që furnizon rrjetin e ujësjellësit industrial për ish KME
Rrjeti publik	Po 0.2 m <sup>3</sup> /ditë së bashku me ambjentet e shërbimit
Pus personal	-
Informacion tjeter	Sasia e ujit është 0.2 m <sup>3</sup> /ditë për nevoja sanitare.



## **Menaxhimi i lëndëve të para**

### **Sistemi i transportit**

Transportimi i lëndëve të para, të cilat luajnë një rol kyç për operimin normal dhe brenda normave të sigurimit teknik, të proceseve që realizohen në objektin ku janë të instaluara linjat për prodhimin e bioksidit të sulsfurit. Transporti sigurohet nga mjetet e shoqërisë të cilat janë në gjendje shumë të mirë funksionale. Furnizimi me lëndë të parë bëhet periodikisht dhe automatikisht sipas kërkesave të linjës së prodhimit të bioksidit të sulsfurit SO<sub>2</sub> sipas formulës përkatëse. Mjetet e transportit janë të kolauduara dhe të mbuluara, me qëllim shhangjen e rrezikut për humbje apo dëmtim të lëndës së parë dhe produkteve gjatë transportit dhe mbrojtjen e mjedisit.

### **Dorëzimi i lëndëve të para**

Mjetet e transportit regjistrohen para hyrjes në territorin e objektit. Bëhet verifikimi i materialit që transportohet brenda tyre, nga drejtuesi teknik i operacioneve dhe magazinieri brenda në objektin e "ELBAGAS" nëse ka mospërputhje të lëndëve të para që janë porositur dhe lëndëve që kanë ardhur në objekt.

Mjetet e transportit parkohen brenda objektit në vendin e caktuar prej shoqërisë, duke ruajtur të gjitha distancat dhe masat e sigurisë, për operimin normal të punës për shkarkimin e ngarkesës.



---

**f) Informacion pér lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth /pranë zonës së projektit**

Ky objekt është brenda zonës industriale dhe aktiviteti i tij është i lidhur me fabrikat e tjera të ish Kombinatit Metalurgjik. Procesi i Prodhimit të SO<sub>2</sub> është lidhur me fabrikën e Oksigjenit që ndodhet po në këtë territor industrial, nga ku bëhet edhe furnizimi me bombola oksigjeni i fabrikës.

**g) Informacion lidhur me alternativat e marra në konsideratë pér sa i takon përgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret**

Përsa i përket zgjedhjes së projektit ndërtimor ky vend ka favore sepse rruga është e ndërtuar afér objektit. Rruga ekzistuese, është e shtruar me asfalt. Teknologjia e ndërtimit është ajo e ndërtimeve të përherëshme betonarmeje, me sipërfaqe të konsiderueshme, me materiale të parapërgatitura dhe të derdhura në vend, me punime me makineri të rënda, betoniera e tjerë. Punimet janë ato të gjermimit, të ndërtimit të bazamenteve, të montimeve dyer e dritare, shtresave të dyshemesë, infrastrukturës së brendëshme dhe të jashtme të objekteve, betonimit e rifiniturës si dhe të mjedisit.

Arsyet pér përgjedhjen e sheshit të ndërtimit dhe teknologjisë së projektit janë:

- Teknologjia e prodhimit të SO<sub>2</sub> është teknologji bashkohore, që krijon shumë pak mbetje të ngurta, dhe me cikël të mbyllur. Instalimet janë të montuara vetëm do të rritet kapaciteti i tyre.
- Projekti dhe teknologjia e prodhimit të SO<sub>2</sub>, është zgjedhur që të ketë një ndikim sa më të vogël në mjedisin pér rreth tij.
- Sipërfaqja e tokës në përdorim të aktivitetit pér "Prodhimin e Dioksidit të Squfurit të Lëngët, SO<sub>2</sub>" është 2184 m<sup>2</sup>, e domosdoshme pér tëkryer aktivitetin e linjës prodhuese.
- Dhe rritjen e prodhimit deri në 500 kg/orë.
- Zona ndodhet brenda zonës industriale eksistuese me infrastrukturë të ngritur pér funksionin e industrisë së rëndë dhe asaj prodhuese.
- Objektet ekzistuese industriale lejojnë funksionin afér tyre tëaktivitetit të planifikuar
- Zgjidhja funksionale e objektit në tërësinë e saj i është përbajtur kërkesave të investorit e harmonizuar kjo me kërkesat pér ngritjen e objekteve industriale sipas ligjit të ri të zhvillimit të hapsirave.
- Eshtë ruajtur pamja panoramike e zonës industriale dhe arkitektura e objektit është përshtatur me objektet ekzistuese.

Kryerja e punimeve pér prodhimin e bioksidit të squfurit, gjithashtu, favorizohet nga:

- Pozicioni arkitektonik i instalimit dhe hapsira e bollshme në dispozicion pér zhvillimin e të gjitha proceseve pér prodhimin e SO<sub>2</sub>, linjat teknologjike të impiantit punojnë në grup me hapsira ndërmjet tyre të cilat nuk pengojnë proceset e njëratjetrës .
- Kërkesa e madhe e tregut të brendshëm dhe jashtëm pér SO<sub>2</sub>



- 
- Distanca e objektit me zonat e banuara, duke mos ndikuar në aktivitetin e tyre bujqësore, ekonomike dhe shoqërore (Zonë Industriale – Ish Kombinati Metalurgjik Elbasan).
  - Objektet dhe linja e prodhimit ndodhen në zonë industriale
  - Instalimet janë të një teknologje bashkohore dhe të çertifikuar dhe me ISO

**gj) Përdorimi i lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasitë e ujit të nevojshëm, energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre**

Për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksjonimit të projektit është squfuri, nitroglycerina si lëndë ndihmëse, oksigeni, uji për stohjen e tubacioneve dhe energjia elektrike. Përsa i përket lëndës djegëse që nevojitet përmjet e punës ajo do të merret në karburantin më të afërt

**h) Aktivitete të tjera që mund të nevojiten përmes zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.; informacion përmes lejet dhe licencat e nevojshme për projektin, të kërkuara nga legjislacioni në fuqi, si dhe institucionet kompetente përmes lejimin/autorizimin/licencimin e projektit**

Për realizimin e aktivitetit përmes "Prodhimin e Dioksidit të Squfurit të Lëngët, SO<sub>2</sub>" nuk nevojiten ngritja e ngrehinave përmes strehimit e fuqisë punëtore. Fuqia punitore që do të punojë përmes proçeset e prodhimit është marrë nga qyteti I Elbasanit dhe transporti I punonjësve deri në fabrikë bëhet nga linjat e autobuzëve të Njësisë administrative Bradashesh.

Dhënia e Lejes së Ndërtimit përmes shtesën 2 kat të objektit është bërë nga Bashkia Elbasan. Dhënia e Lejes së Mjedisit është bërë nga Ministria e Mjedisit. Shoqëria "ELBAGAS" sh.a ka filluar procedurat përmes përsëritjen e Lejes Mjedisore duke qenë se ka ndryshim të kapacitetit prodhues nga 160 kg/orë në 500kg/orë Dioksid Squfuri.

Përsa i përket dokumentave ligjore të projektuesve dhe specialistëve të fushave të ndryshme cilësojmë se, të gjithë hartuesit e këtij projekti, dhe hartuesit e Raportit të Mjedisit janë të paisur me licensat nga Ministratë përkatëse dhe ndodhen bashkëngjitur këtij materiali. Bashkëngjitur këtij materiali ndodhet edhe dokumentacioni i konsultimit me publikun përmes aktivitetit "Prodhimi i Dioksidit të Squfurit" përmes shoqërinë "ELBAGAS" sh.a.

**3.Një përvetësim i analizimit të alternativave të mundshme përmes zbatimin e projektit ose komponentëve të veçanta të tij (si: aksesi rrugor, administrimi i mbetjeve dhe ujërave të ndotura, llojet e lëndëve djegëse, vendndodhja e projektit etj.), si dhe sqarimi i arsyeve kryesore përmes alternativëve propozuar, duke marrë parasysh ndikimet në mjedis të secilës alternativë, si dhe, në rast se ka, mendimet dhe sugjerimet e institucioneve përgjegjëse që mbulojnë fushën e zbatimit të projektit**

-Aktiviteti përmes "Prodhimin e Dioksidit të Squfurit" është i lidhur me infrastrukturën përkatëse në të gjithë drejtimet. Ai lidhet me aksin kryesor të autostradës Elbasan -Metalurgji dhe Elbasan -Tiranëme rrugë të shtruara.

-Nga aktiviteti nuk krijohen mbetje të rrezikshme. Mbetje të ngurta që mund të prodhohen janë akutare skorjeve që prodhon surra(Trajte Gurësh). Këto mbetje, prodhohen nga pastërtitë që mund të ketë Squfuri si lëndë e parë, që nuk ze më shumë se 1-2% të tij. Mbetjet mund të janë lloj qymyri dhe sasia e prodhimit të tyre përmes gjithë vitin, nga i cili



punohet vetëm 1-2 muaj është rreth 40 kg. Këto mbetje duke qenë në trajte të ngurtë dhe të pa tretshme, nuk përbëjnë problem për kontenierin e mbetjeve të ngurta të Kombinatit Metalurgjik. Ato depozitohen për menaxhim së bashku me mbetjet e ngurta të llojeve të tjera të gjithë kombinatit. Këto mbetje duhet të menaxhohen duke u depozituar dhe sistemuar kundër ekspozimit ndaj efektit të erozionit dhe përhapjes së tyre në mëdis. Ato duhet të menaxhohen nga një subjekt i licensuar dhe që ploteson kriteret për menaxhimin e tyre. Zakonisht keto material shkojnë per mbushje rrugesh.

-Ujra teknologjike nuk shkarkohen në kanalizime me përfjashtim të ujrate sanitare. Nga ana e subjektit bëhet riqarkullim i ujit dhe bëhen shtesa të tij përfshirë avullimit gjatë procesit.

-Persa i përket lëndës djegëse: Procesi i prodhimit të gazit sulfuror( $\text{SO}_2$ ) të lëngëzuar bazohet në realizimin e disa stadeve të përpunimit të lëndëve të para, squfurit dhe oksigjenit. Nëpërmjet dhënies nga jashtë të energjisë termike, squfuri shndërrrohet në squfur të shkrirë e më pas kemi oksidimin e squfurit të shkrirë e të sublimuar, në bioksid të squfurit të sublimuar në rrymën e oksigjenit të pastër sipas reaksionit  $\text{S} + \text{O}_2 = \text{SO}_2 + 70,9\text{ kkal}$ .

Përfundimisht duhet thënë se aktiviteti i prodhimit të  $\text{SO}_2$  nuk krijon probleme mëdisore

#### **4. Një përshkrim të gjendjes dhe vlerave ekzistuese të mëdisit, që mund të ndikohen nga zbatimi i projektit të propozuar, duke përfshirë:**

##### **4.1 Përshkrimin e karakteristikave fizike të zonës së projektit**


- Përshkrim të faktorëve klimatikë

Ajri, uji, faktorët klimatikë, zhurmat etj.

**Temperatura.** Zona e Bradasheshit, sipas ndarjes klimatike të Shqipërisë, bën pjesë në zonën mesdhetare kodrinore dhe nën-zonën mesdhetare kodrinore qendrore. Larmia e formave të reliefit dhe shtrirja e gjërë veri-jug e kësaj nën-zone ndikojnë regjin e elementeve klimatikë. Temperatura mesatare e ajrit është ajo e qytetit të Elbasanit, dhe varion nga  $6.7^{\circ}\text{C}$  në Janar deri në  $23.4^{\circ}\text{C}$  në Korrik.

Temperatura mesatare maksimale varion nga  $11^{\circ}\text{C}$  në janar deri ne  $31.2^{\circ}\text{C}$  në korrik. Temperatura mesatare minimale varion nga  $2.2^{\circ}\text{C}$  në janar deri në  $15.8^{\circ}\text{C}$  në Korrik. Temperatura minimale absolute është regjistruar në Janar të vitit 1968 me  $-7.5^{\circ}\text{C}$  dhe ajo maksimale absolute është regjistruar në Korrik 1988 me  $42^{\circ}\text{C}$ .


Tabela Grafiku i temperaturave



**Rrezatimi diellor.** Regjimi i rrezatimit karakterizohet nga një sasi vjetore e rrezatimit diellor prej  $1448.5 \text{ k}\dot{\text{e}}\text{h/m}^2$ , ku vlera më e ulët haset në dhjetor me  $50.1 \text{ k}\dot{\text{e}}\text{h/m}^2$  dhe vlera më e lartë të korrik me  $202.1 \text{ k}\dot{\text{e}}\text{h/m}^2$ . Gjatë vitit hasen mesatarisht 2442 orë me diell. Muaji me numrin më të lartë të orëve me diell është koriku (326 orë), ndërsa dhjetori ka vetem 111 orë me diell, ç'ka është dhe vlera më e ulët gjatë vitit. Ky rrezatim diellor është patur parasysh në ndërtimin e objektit ku do të realizohet aktiviteti për "Prodhimin e Dioksidit të Sufurit të Lëngët SO<sub>2</sub>", në orientimin e objektit, në projektimin e hapsirave të dritës, në orientimin e harmonizimin e fasadës së objektit me anët e horizontit.

Eraështë një tjetër element i rëndësishëm klimatik për të cilin në përgjithësi mund të thuhet se zona e Bradasheshit karakterizohet nga vlera të larta të qetësisë (rreth 53%) dhe shpejtësi mesatare minimale  $1.2 \text{ m/s}$  gjatë verës e shpejtësi mesatare maksimale  $2.1 - 2.4 \text{ m/s}$  në dimër. Erërat që fryjnë nga verilindja janë dominuese gjatë gjithë vitit dhe vlerën maksimale e arrijnë në dimër me  $4.7 \text{ m/s}$ . Në pranverë shfaqet drejtimi dominues, jugperëndimi me rastisje 11.9%.

Tabula Matje të intensitetit të erërave



Ndikimi i jugperëndimit vazhdon të jetë i fortë gjatë verës, ndërsa gjatë vjeshtës forcohet përsëri veprimi i erërave verilindore. Drejtimi veriperëndimor arrin vlera të larta shpejtësie në vjeshtë, por ndikimi i tij është i papërsillshëm për shkak të rastisjes së ulet prej 1.3%.

**Reshjet.** Përsa i përket reshjeve, pjesa më e madhe e tyre bien në gjysmën e dytë të vitit dhe më pak në gjysmën e ngrrohtë, për shkak të aktivitetit ciklonik. Gjatë gjysmës së ftohtë bie 65.8% e shumës vjetore të reshjeve dhe gjatë gjysmës së ftohtë bie 34.2%. Shuma vjetore e reshjeve është 1148 mm, ndërsa maksimumi 24 orë i reshjeve është 134.9 mm. Reshjet në formë bore janë dukuri e rrallë për zonën e Elbasanit ku bën pjesë edhe territori dhe objekti ku do të realizohet procesi teknologjik për "Prodhimin e Dioksidit të Sufurit të Lëngët SO<sub>2</sub>". Numri i ditëve me shtresë bore është i ulët dhe ka një vlerë mesatare prej 1.2 ditë në vit.

**Infrastruktura rrugore.** Objekti i ka të gatëshme infrastrukturat rrugore duke komunikuar direkt me rrugën e brendëshme të ish Kombinatit Metalurgjik, që lidh qendrën e qytetit të Elbasanit me Njësinë Administrative Bradashesh.

**Zhurmat.** Duke qenë se është zonë industriale, zhurmat janë të pranishme gjatë fazës së zhurte zhifte të objektit. Gjatë fazës së prodhimit të gazit sulfuror, zhurmat nga automjetet (së një ndikim që duhet të merren në konsideratë, ato janë të vazhdueshmeedhe pse



Në zonën në studim ka monitorime të realizuara në zonën industriale.

Tabela Vlera e emetimit të zhurmave nga automjetet.

Paisja	Vlerat
Uzina 12	58-68 Leq dB(A) ne 15m
Në hyrje të kombinatit kalojnë kamiona	55- 76-78 Leq dB (A) ne 15 m

Zhurmat në objektin që shfrytëzohet për prodhimin e SO<sub>2</sub>do të shkaktohen nga transportidhe nga procesi teknologjik, prandaj shoqëria duhet të përdori teknologjinë e fundit të paisjeve prodhuese të gazit sulfuror për të ulur vibrimet dhe nivelin e zhurmave.

#### - Përshkrim gjemorfologjik dhe të sizmicitetit të zonës së projektit;

##### Gjeologjia dhe Gjemoorfologjia

Pjesa e territorit ku është ndërtuar objekti ku do të realizohet aktiviteteti për "Prodhimin e Dioksidit të Sufurit të Lëngët - SO<sub>2</sub>", është i përbërë nga formacione molosike.

Nga pikëpamja strukturore e morfollogjike, fusha e Bradasheshit është vendosur në një taracë lumore, shkallët e së cilës janë formuar nga depozitimet poluviale të lumi Shkumbin gjatë periudhës kuaternare (Q4 pl), si pasojë e krijuarit të shtratit të tij. Kjo taracë është e ndërtuar nga depozitime të përbëra nga formacione argjilore, konglomeratike aleorolitore me ranorë të rrallë. Në prerjen tërthore të depozitave vërehen alternime të këtyre depozitimeve. Ekzistencë e një litologji të tillë, dëshmon se kemi të bëjmë me formacione gjeologjike me qëndrueshmëri mekanike të vogël.

Nga pikëpamja gjeologjike, fusha e Bradasheshit zë vend në qoshen jug-perëndimore të zonës së shkëputjeve normale tërthore Elbasan-Dibër, e cila përbëhet nga shkëputje fragmentare me shtrirje VL përreth 60 km brenda territorit tonë.

#### - Përshkrim të gjeologjisë dhe tokës në zonën e projektit

##### Depozitimet e Kuaternarit (Q4 al)

Depozitimet aluviale përfaqësohen nga zhavorre kokërr vogël deri në zhure, rëra, surëra , suargjila dhe argjila. Janë depozitime pak deri në mesatarisht të konsoliduara, takohen në gjithë zonën ku është bërë ndërtimi i objektit.

Fusha ku është kryer studimi përfaqeson një gropë të thellë me origjinë tektonike e cila në periudhën e Kuaternarit është mbushur me depozitime aluviale. Në gropën e Elbasanit ka një fenomen të ndryshëm nga rastet e tjera, këtu ka një përmbyssje të depozitimeve. Nga shpimet ekryera në zonën e fushës së Elbasani terracat me të vjetra janë nënterracat e reja.

##### Depozitimet e Paleogenit (Pg31)

Nën depozitimet e Kuaternarit takohen depozitimet e Paleogenit që përbëhen nga argjilite dhe alevrolite me ngjyrë gri me çimentim të dobët deri mesatar, pjesa e sipërme e këtyre depozitimeve është e përafjruar. Këto depozitime dalin në sipërfaqe në kodrat e Krastës dhe të Cerrikut. Këto depozitime nuk janë të rëndësishme për objektin endërtuar sepse takohen në thelli të medha.

##### Gërryerja e tokës në brigjet e lumenjve (Burimi informacionit:MM)

Monitorimi i gërryerjes së tokës në brigjet e lumenjve.

Ky tregues është matur në brigjet e lumenjve Shkumbin dhe Vjosë, nëpërmjet metodës së rilevimit topografike në segmentet më problematik. Në këto vitet e fundit dëmtimet në brigjet e lumenjve, janë rezultat i shfrytëzimit të materialeve inerte në shtretërit e lumenjve, dëmtimi i objekteve mbrojtëse dhe dëmtimi i vegjetacionit përgjatë shtratit të tyre. Vlerësimi i gërryerës së tokave në brigjet e lumenjve Shkumbin dhe Vjosë, është bërë dy herë



---

gjatë vitit 2012 dhe është përdorur metoda e matjes, rilevimit dhe hartimit të profileve topografike tërthore rrjedhëse ujore nëpërmjet repereve fiks.

### Vlerësimi i gjerryerjeve të tokës në brigjet e lumbit Shkumbin.

Procesi i monitorimit të pellgut të lumbit Shkumbin është kryer në afërsi të fshatit Obot dhe ky vlerësim është bërë nëpërmjet hartimit dhe aplikimit të profilave gjatësorë. Qëllimi i kësaj ndërhyrje ka qenë evidentimi i rolit të ndryshimit të reliefit të tokës në bregun e lumbit, humbjet e tokës, dhe mbi këtë bazë të bëhej e mundur përcaktimi i masave për parandalimin dhe pengimin e fenomenit të erozionit.

Gjatë vitit 2012 nga matjet e bëra në gjatësinë e segmentit të monitoruar në lumin Shkumbin, u vrojtuan ndryshime jo sinjifikative në bankinat e shtratit të lumbit gjë që tregon se për këtë vit nuk kemi evidentim sasior të kësaj forme të erozionit lumenj.

Matjet janë realizuar në kordinatat e mëposhtëme:

Pika 1 N.= 41 45 342 Pika 2 N =41 45 567

Pika 1 E = 19.46.300 Pika 2 E = 19 46 450

Shkumbini është nga lumenjtë më të mëdhenj në Shqipërinë Qëndrore. Është 181 km i gjatë, sipërsfaqja e pellgut 2444 km<sup>2</sup>, dhe lartësia mesatare mbi nivelin e detit është 753 m. Grykëderdhja e tij është në detin Adriatik, në pjesën jugore të lagunës së Karavastasë. Shkumbini buron nga pjerrësite lindore të Valamarës dhe malet e Gurit të Kamjes. Në Librazhd ai bashkohet me përruin e Rrapunit. Në luginën e Elbasanit, shtrati i tij zgjerohet dhe rrjedh drejt Perëndimit deri në fushën bregdetare në afërsi të Rrogozhinës, ku transformohet në lumë fushor.

Në pellgun e Shkumbinit ka larmi gëlqerorësh, nga ku burojnë shumë burime karstike të rëndësishme, si ai i Krastës me 500 l/s. Prurja mesatare shumëvjeçare e Shkumbinit është 61,5 m<sup>3</sup>/sek. Ai transporton mesatarisht 5,8 milionë tonë lëndë të ngurta në vit. Temperaturat lëvizin nga 6,3oC në janar deri 22oC në gusht. Mineralizimi i ujërave është rrëth 317 mg/l.

Studimet tregojnë cilësi relativisht të mirë të ujërave. Megjithatë, Shkumbini ka qenë dhe mbetet lumë me probleme mjedisore. Veçanërisht ndikim të madh kanë luajtur mbeturinat e shkarkuara nga Kombinati Metalurgjik i Elbasanit, Sasi të mëdha të lëndëve ndotëse janë shkarkuar drejtpërdrejt në lumë, ndërsa në brigje janë hedhur sasi të mëdha mbeturinash të ngurta nga aktivitetet e Kombinatit. Para viteve 1991, është vlerësuar që prej këtij objekti industrial janë shkarkuar në Shkumbin 30-35 milionë m<sup>3</sup>/vit mbeturina të lëngëta me përbajtje shumë të madhe të lëndëve helmuese si: cianuret, fenolet, NH<sub>3</sub> etj. Gjithashtu, në brigjet e tij shkarkoheshin rrëth 800 ton në ditë mbeturina të ngurta.

### - Përshkrim të ujërave sipërsfaqësore dhe nëntokësore në zonën e projektit

#### Përshkrimi i ujrale sipërsfaqësore dhe nëntokësore të zonës

##### Hidrogjeologjia

Në rajonin e Elbasanit takohen depozitime të sistemeve të triasikut (T), kretakut (Cr), paleogenit (Pg), neogenit (N), kuaternarit (Q) si dhe shkëmbinj intruzive ultrabazike ( $\sigma J_{2-3}$ ). Sasia mesatare e reshjeve vjetore prej 1210 mm / vit furnizon një rrjet hidrografik të pasur. Rrjedhjet sipërsfaqësore më të rëndësishme janë Lumi i Shkumbinit, Përroi i Zaranikës, Përroi i Kushës dhe i Manasderes. Përbërja petrografike ka ndryshime të mëdha në pozicione të ndrysluara rrjedhjes së lumbit të Shkumbinit. Deri në Elbasan përbërja është: Magmatike 10-35%; Karbofare 40-30%; Silicore (Kuarcore) 50-35%.



Tabela Karakteristika e rrjedhjes ujore të Shkumbinit e dy përrrenjve që derdhen në të

Nr	Aksi	Sipërfaqja e pellgut (km <sup>2</sup> )	Rrjedha Ujore		
			Prurja (m <sup>3</sup> /s)	Moduli (l/s/km <sup>2</sup> )	Shtresa (mm)
1	Shk – Murrash	1289	33.4	25.9	817
2	Shk – Papër	1958	53.6	27.3	862
3	P. Kusha	74.5	1.37	18.4	579
4	P. Zaranika	60	1.86	31	978

Nga analiza e informacionit shumëvjeçardel se rrjedhja ka një shpërndarje stinore e cila kulmon në stinën e pranverës (stina me më shumë ujë) me 35-40% të rrjedhjes vjetore. Më pas vjen dimri me 31-35%, vjeshta me 14-16% dhe vera me 13-15%. Komuna e Bradasheshit ka dy përrenj të konsiderueshëm; në Lindje Përroi i Zaranikës. Përroi i Zaranikës është cilësuar si përrua i rrëmbyeshëm që gjithmonë ka shkaktuar probleme të përmbytjes në qytetin e Elbasanit dhe fushën e Bradasheshit. Ai ka prurje të mëdha të gurëve dhe të inerteve.

Përroi i Kushësnë një pjesë të tij kalon në një kanal betoni që funksion normalisht. Në dalje të Njësisë Administrative Bradashesh, ky përrua krijon gjithmonë probleme sepse del nga shtrati i tij, që është tepër i ngushtë dhe i ngarkuar me prurje. Shtresa ujëmbajtëse e depozitimeve të shkrifta aluviale në luginën e Shkumbinit ka përhapje nga fshati Labinot në lindje deri në Cërrik-Papër në perëndim me një gjatësi rreth 18 km. Gjerësia e shtresës ndryshon nga 1 km në 7 km e para në lindje të Krastës deri në 5 km në perëndim të Krastës dhe të qytetit të Elbasanit. Trashësia e shtresës është mbi 50 m në pjesën lindore, ndërsa në pjesën perëndimore është mbi 100m. Mendohet se potanca në pjesën perëndimore është 180 - 200m, ndërsa në lindje 80 – 100m. Vetëm në Krastën e Vogël, shtresa ujëmbajtëse e zhavoreve aluviale ka trashësi 10.3m. Litologjia e shtresës ujëmbajtëse përfaqësohet törësish nga zhavorre të trasha gëlqeroresh, ultrabajzikësh e më pak ranoresh me përbajtje deri në 20% rërë. Kompleksi i karbonateve ka rezerva të kufizuara që shkarkohen në formë burimesh natyrore në zhavorret aluviale pranë strukturës së Krastës së Madhe dhe të Vogël.

#### Përshtrim i ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë në zonën e projektit.

Në zonën e zbatimit të këtij projekti ka burime ujore të identifikuara. Por këto burime ujore nuk ndodhen në brendësi të pronës/sipërfaqes në vlerësim, por në një distancë të afërt. Konkrektisht burimi ujor më i afërt është Lumi Shkumbin. Përsa i përket distancave që objekti ruan me këto burime ujore sqarojmë se Shtrati i Lumin Shkumbin kalon rreth 520m në vijë ajrore në jug të objektit. Zona është me relief të sheshtë dhe ndodhet në brendësi të Kombinatit Metalurgjik. Objekti nuk ndodhet në brendësi të burimeve ujore të rëndësishme si Liqene, Laguna apo zona Bregdetare.

**Kushtet Hidrogjeologjike.** Nga studimet e kryera në zonën e ish Kombinatit Metalurgjik në Elbasan (nga matjet e kryera në shpimet për disa vite në punimet e ndryshme që autoret kanë kryer në zonën e Elbasanit) rezulton se niveli i ujit nëntokësor në dimër dhe në verëështë i ndryshëm. Autorët e këtij studimi kanë shfrytëzuar të gjitha punimet ekzistuese dhe punimet e reja në to që janë kryer matje në disa kohë gjatë gjithë periudhës së studimit dhe rezulton se në pjesën më të madhe të zonës niveli i ujit nëntokësor është afër sipërfaqes së tokës (-10.00-11.50m) me sipërfaqja e tokës natyrore. Ky nivel i ujrale nëntokësore përfaqëson nivelin minimal të tij nëntokësor. Në kohën e dimrit ky nivel është më afër nga sipërfaqja e tokës



---

natyrore. Nga matjet ekzistuese rezulton se niveli i ujit në dimër është -4.50m. Nga analizat e kryera rezulton se ujrat nëntokësore janëneutral, nuk janë agresive karshi hekurit dhe betonit.

Foto Pamje të Lumit Shkumbin, pjesa e shtratit të Lumit, në zonën Bradashesh



## 2.2 Përshkrimi i biodiversitetit në zonën e projektit:




Përshkrimi i habitateve kryesore në zonën e projektit, si dhe harta ilustruese  
Konsiderata të përgjithëshme për biodiversitetin e zonës përreth

---

Gjelbërimi i zonës ku kryhet aktiviteti industrial për "Prodhimin e Dioksidit të Sufurit të Lëngët - SO<sub>2</sub>", është një tjetër tregues i gjendjes mjedisore. Gjelbërimi dhe mirëmbajtja e sipërfaqes së gjelbërt në këtë njësi administrative kryhet aktualisht nga Bashkia Elbasan. Gjelbërimi në zonën e ndërtimit është ai privat me bimësi të ulët e pemë të mbjella në distancë dhe gjelbërimi i rrugëve të brendëshme të kompleksit industrial.

Foto Pamje e bimësisë së zonës në Njësinë Administrative Bradashesh



**Habitatet dhe biodiversiteti.** Territori i Njësisë Administrative Bradashesh dallohet për gjelbërimin vetiak. Zona që studiohet ka pasur bimësi të ulët, bar dhe bimësi të vogël e të egër që luajnë një rol pak të rëndësishëm në ekosistemin e zonës. Më parë ajo është përdorur si truall i lirë.

Shpendi më i spikatur për zonën është kumria dhe harabeli. Karakteristikat klimaterike, topografia, tokat ujërat dhe prania e njeriut bëjnë që territori të karakterizohet me habitate me vlera jo të veçanta, karakteristika tipike të habitatit të menaxhuar me intensitet dhe pa vlera pozitive të biodiversitetit. Zona klasifikohet në habitate tokësore të kultivuara dhe të menaxhuara. Territori fushor është i rrethuar nga kodra të mbjella me ullinj, ç'ka tregon për sipërfaqe të tokave të menaxhuara intensivisht e me mbulesa gjysëm artificiale të vegetacionit. Territori në afërsi të zonës ka një mbulesë barishtore të ulët ku shfaqen forma të çikores së egër.

**Flora dhe fauna.** Duhet thënë se objekti është brenda Kompleksit Metalurgjik i cili ka mbi 40 vjet që ushtron aktivitetin e tij prodhues në këtë rajon. Të tilla zhvillime kanë dhënë influencat e tyre në florën dhe faunën e zonës. Është tjetësuar tërësisht sipërfaqja e truallit gjatë kësaj periudhe kështu që për zonën përreth nuk kemi zhvillime normale të florës dhe të faunës.

Bimësia natyrore përfaqësohet nga mbeturina të shkurreve mesdhetare, dushku apo shelgu. Në fushat rreth subjektit kultivohen drithërat e bukës: gruri, misri si dhe duhani e rrushi. Është zonë e kultivimit të ullirit, fikut kumbullës.

Foto Pamje e bimësisë në zonën e objektit të Prodhimit të Gazit Sulfuror SO<sub>2</sub>





**- Përshkrimi i vegjencionit në secilin habitat dhe statusin e ruajtjes kombëtare dhe ndërkontrolluese të tyre**

Aktiviteti në vlerësim është një instalim i cili prodhon në rrugë industriale Gazin SO<sub>2</sub>. Ky aktivitet është ekzistues dhe ndodhet në brendësi të Kombinatit Metalurgjik, pranë Uzines 12, Njësia Vendore Bradashesh, Bashkia Elbasan. Terreni është i sheshtë dhe ndodhet në zonëindustrial ekzistuese. Bimësia që karakterizon këtë zonë, përfshinat të cilat janë të banuara dhe të lira nga ndërtimet janë kulturat bujqësore dhe bimësia barishtore e pemëve të larta, por këto të fundit të rralla e jo në trajte pyjesh e habitatesh. Kulturat bujqësore të zonës variojnë nga më të ndryshmet, duke përmendur drithërat, foragjeret, perimet, pemët frutore, agrumet, vreshtat e rruhit, ullinjtë, etj. Bimësia e rajonit është kryesisht shkurre-Barishtore dhe pjesërisht dru pyjore në lartësitë e maleve e kodrave (edhe përgjate kanaleve kullues dhe në oborret e banesave dhe objekteve private). Siç shihet edhe nga ortofotot dhe nga fotot e zonës, ky aktivitet ndodhet në një zonë industriale, me kapanone të vjetra ekzistuese të cilat kanë funksionuar historikisht si të tilla përfshimin në rrugë industriale të Gazit SO<sub>2</sub> (Bioksid Squfuri). Madje edhe një pjesë të makinerive të perpunimit janë të teknologjisë ekzistuese të Kombinatit Metalurgjik. Ky aktivitet nuk prek zona pyjore, apo zona të mbrojtura me ligj. Nuk do të ketë ndërtim téri dhe nuk do të zihet sipërsfaqe e re toke. Objektet janë të hipotekuara. Përsa i përket Klimës, ajo është tipike mesdhetare, kontinentale dhe veçanërisht kjo zonë karakterizohet nga një klimë e butë e me rreshje tëregullta. Dimri është i butë, ndërsa pranvera dhe vera janë muaj të nxehë. Kjo zonë është e pasur me burime ujore dhe karakterizohet nga një numër rezervuare bujqësore, nga Lumi Shkumbin dhe degët e tij, etj.

**- Përshkrimi i faunës në secilin habitat dhe statusin e ruajtjes kombëtare dhe ndërkontrolluese të tyre**

Në blektori zona e Bradasheshit shquhet përfshirë rritjen e lopëve, të derrave, të imtave e shpendëve. Takohen mjaft zogj me banim të përhershëm por edhe shtegtarë të cilët popullojnë zonën duke përfshirë këtu edhe territorin e stabilimentit. Në kafshët e egra kemi popullim të lepurit të egër, por jo rrallë takohet edhe dhelpra dhe në stinën e ftohtë, pjesa pranë bregut të lumit Shkumbin popullohet me shpezë të egra si rosa, bajza, shapka etj. Përsa i përket bimësisë së zonës jashtë konturit të sipërsfares së ushtrimit të aktivitetit ajo përbëhet kryesisht nga sipërsfaqe publike dhe private të gjelbëruara.



Përshkrimi i zonave të mbrojtura pranë vendit ku propozohet të zbatohet projekt, përfshirë edhe monumentet natyrore të mbrojtura me ligj

Foto Fragment i rajonit nga harta e zonave te mbrojtura.




Tabela Monumentet Natyrore te Rrethit Elbasan.(Sipas VKM 676)

Nr.	Monumenti Natyror	Nr.	Monumenti Natyror
1	Frasher i Polos Vale	13	Dushku i Kishes Gjinari
2	Pylli aluvial i Shushices	14	Lisat e Pashtreshit
3	Shpella e Letanit	15	Mani i Zi i Joronishtit
4	Hinka e Kosoves (Dumre)	16	Rrepert e Byshekut
5	Mali (Shkembi) i Gradishtes	17	Robulli i Zeleshnjes
6	Shpella e Gracenit	18	Rapi i Bezistanit
7	Liqenet e Seferanit	19	Rapi i Vojvodes
8	Liqeni i Deges (Dumre)	20	Rrapi i Gurres se Labinotit
9	Burimi i Llixhes se Hibrait	21	Ulliri i Qejfit
10	Dushku i Lleshanit	22	Rrapi i Llixhes
11	Meshtekna e Zavalines	23	Rrapi i Uruçes
12	Pisha e Fushe Kuqes Gjinari		

#### Gërmimet arkeologjike.

Elbasani është si vend-banim i hershëm ilir, si rrjedhojë edhe objektet monumentale të këtij kohë së shumta. Njihen dhe janë të miratuar me ligj rreth 85 objekte, banesa, kala, qendra historike, si objekte me rëndësi arkeologjike të kategorisë së parë dhe të dytë. Ato ndodhen në distancë me zonën ku zhvillohet projekti.



## 2.3 Përshkrimi i cilësisë së mjedisit dhe ndikimeve ekzistuese

### - Cilësia e ujërave në zonën e studiuar për hartimin e raportit të thelluar të VNM-së


Monitorimi i cilësisë së ujrove sipërsaqësorë është realizuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Vlerimi i cilësisë së tyre përcaktohet në bazë të parametrave fizikokimikë duke i krahasuar me normat e lejuara të përcaktuara në Direktivën Kuadër të Ujit të BE.

#### Baseni i Shkumbinit

Rrjeti i monitorimit përbëhet nga katër stacione, Qukës, Topçias, Papër dhe Rrogozhinë, në të cilat vlerësohet gjëndja e ujrove të këtij lumi në rrjedhën e sipërme, në rrjedhën e mesme dhe në rrjedhën e poshtme para derdhjes së lumi në det.

Në të katërt stacionet e basenit të Shkumbinit përmbajtja e oksigenit të tretur është e lartë duke e klasifikuar të cilësisë shumë të mirë, ku vlera e tij varjon nga 9.5 mg/l në stacionin referencë Qukës në 8.2 mg/l në stacionin e ura e Rrogozhinës.

Tabela




Në stacionin referencë Qukës, përmbajtja e lëndëve organike rezulton në nivele të ulta dhe klasifikohet i cilësisë së dytë. Kemi rritje konstante të këtij treguesi duke filluar nga stacioni i Topçiasit ku kemi shkarkimet urbane të qytetit të Elbasanit të cilët ndikojnë direkt në rritjen e përmbajtjes së lëndëve organike. Si pasojë segmenti i lumit nga Topçias e deri në urën e Rrogozhinës klasifikohet i cilësisë së tretë, gjendje e moderuar.

Tabela




### Përmbajtja e NBOs



Në stacionin referencë Qukës përmbajtja e lëndëve organike rezulton në nivele të ulta dhe klasifikohet i cilësisë së dytë. Kemi rritje konstante të këtij treguesi duke filluar nga stacioni Topçiasit, ku kemi shkarkimet urbane të qytetit të Elbasanit të cilët ndikojnë direkt në rritjen e përmbajtjes së lëndëve organike. Si pasojë segmenti i lumbit nga Topçias e deri në urën e Rrogozhinës klasifikohet i cilësisë së tretë, gjëndje e moderuar.

Tabela


### Përmbajtja e NKO



Në të katër stacionet e basenit të Shkumbinit përmbajtja e NKO varion në 4.36 mg/l në stacionin referencë Qukës, në 9.59 mg/l në stacionin Topçias si pasojë e shkarkimeve urbane të qytetit, në 7.2 mg/l në Papër dhe me 7.6 mg/l në stacionin ura e Rrogozhinës.


Tabela






Në të katërt stacionet e basenit të Shkumbinit përmbajtja e fosforit total plotëson kërkesat e cilësise shumë të mirë dhe varion nga 0. 056 mg/l në stacionin referencë Qukës në 0. 063 mg/l në stacionin Topçias e Papër dhe me 0. 08 mg/l në stacionin e ura e Rrogozhinës.

Tabela



Në të katër stacionet e basenit të Shkumbinit përmbajtja e NO<sub>2</sub> plotëson kërkesat e një cilësie shumë të mirë të ujrave për dy stacionet e para dhe varion nga 0. 004-0.008 mg/l. Në dy stacionet e tjera ka një rritje të vogël dhe varion nga 0. 016-0. 023-mg/l.

Tabela




Në të katër stacionet e basenit të Shkumbinit përmbajtja e NH<sub>4</sub> varion nga 0. 067-0. 216-0. 106-0. 09 mg/l për stacionet Qukës, Topçias, Papër dhe Rrogozhinë. Vlera më e lartë paraqitet në Topçias si rezultat i shkarkimit të kolektorëve të ujrave urbane të qytetit të




Elbasanit. Në dy stacionet Papër dhe Rrogozhinë vërehet një reduktim i përmbajtjes së NH4. Vlerat e përmbajtjes së amonjakut e klasifikojnë lumenj e Shkumbinit të cilësisë së dytë.

Tabela



Gjendja: Treguesit NO3 në basenet lumore të Shqipërisë është e lartë ose klasa I Trendi: Treguesit NO3 në basenet lumore të Shqipërisë në vite paraqitet në vlera të ndryshme brenda basenit, por përmbajtja e tyre në ujrat e lumenjve është e ulët në krahasim me normën e cilësisë së mirë.

Tabela



Burimi i informacionit: Raporti i gjendjes se mjedisit për vitin 2014, Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit(Faqja Zyrtare).

#### - Cilësia e ajrit në zonën e studiuar për hartimin e rapportit të thelluar të VNM-së

Vlerësimi i situatës nga pluhurat (PM10, PM2.5).

Grimcat e pluhurit (PM) janë një përzierje e aerosoleve ( të ngurta ose të lëngëta ) që përfshin një diapason të gjerë në madhësi dhe kompozime kimike. PM10, PM2.5 i referohet grimcave me diameter 10 dhe 2.5 micrometer ose më të vogël, dhe emetohen direkt në atmosferë si grimca primare ose formohet si rezultat i emisioneve të SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, NH<sub>3</sub> dhe NMVOC PM emetohen nga shumë burime antropogenike si djegia e lëndës djegëse, ndërtimet, pluhuri natyral pezull, kripa e detit etj. PM mund të shkaktojnë dhe përkqësojnë sëmundjet e zemrës dñe, moshkërive, goditje në zemër dhe aritmi. PM mund të dëmtojnë sistemin nervor qendror, sistemin prodhues dhe mund të shkaktojnë kancer. Një nga rezultatet e eksponimit të PM mund të shkaktojë vdekje të parakohshme.




### Cilësia e ajrit në zonën në studim.

Ndotja e ajrit është njëproblem i madh për Njësinë Administrative të Bradasheshit, edhe për zonën ku funksionon objekti për "Prodhimin e Dioksidit të Sulfurit të Lëngët - SO<sub>2</sub>". Në territorin e kësaj njësie administrative ndodhen prodhuesit më të mëdhenj në vend të industrisë së rëndë dhe asaj ndërtimore, ish Kombinati Metalurgjik, Fabrika e Prodhimit të Çimentos në fshatin Balëz ECF, Fabrika e Prodhimit të Ferrokromit, Fabrika e Masës Karbonike si dhe një sërë objektes të tjera industriale. Ndotja e ajrit ka si burim jo vetëm industrinë por edhe transportin urban e infrastrukturën e dëmtuar rrugore, djegien e mbeturinave të ngurta, sektorin e ndërtimit, djegien e gazeve propan e butan për ngrohje dhe gatim, mënyrën ekzistuese të pastrimit të shesheve, trotuareve, rrugëve etj.

Ndër faktorët industrialë përmenden Kurum International, Ferrokromin, ECF, etj. Pothuajse të gjitha këto firma raportojnë se kanë kryer investime në skemat e tyre teknologjike me synim uljen e nivelit të shkarkimeve në mjedis (ajër). Monitorimet kryhen për SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, CO, dhe për lëndën e ngurtë. Monitorimi i ajrit urban, bëhet nëpërmjet matjeve në 1 pikë të qytetit të Elbasanit dhe kryhet për LGP, PM<sub>10</sub>, SO<sub>2</sub>, NO<sub>2</sub>, Ozonin dhe Pb si dhe për subjekte të mëdha industriale. Matjet tregojnë se vlerat e shkaktuara nga industritë në ajrin urban në përgjithësi kanë një lloj rënje, megjithatë në përgjithësi vlerat e pluhurit të respirueshëm PM<sub>10</sub> mbeten më të larta se normat e lejuara.

Foto Pamje nga ish Kombinati Metalurgjik Elbasan



Lënda e grimcuar pezull dhe në veçanti pluhuri i respirueshëm, konsiderohen si tepër të rrezikshëm për shëndetin sepse duke u transportuar lehtësisht nga era dhe agjentët atmosferike, jo vetëm ulin shikueshmërinë dhe rritin papastërtinë në ndërtesa, por depozitohen në rrugët e frysma marrjes duke dëmtuar veçanërisht mushkëritë. Ato janë burime të kancerit. Gazrat e tjera si psh SO<sub>2</sub> dhe NO<sub>x</sub>, veç rrezikut mbi shëndetin, sjellin dëme dhe për ndërtesat e veçanërisht monumentet e kulturës duke ulur në mënyrë graduale cilësinë dhe fortësinë e tyre. **Cilësia e ajrit për Elbasanin, Njësinë Administrative Bradashesh dhe zonën përreth**


Zona rezulton me ajër të ndotur si zonë me zhvillim industrial.



Tabela Rezultatet mesatare vjetore për periudhën 2001-2012

Viti	LNP	LNP	LNP	PM10	PM10	PM10
	Elbasan 1	Elbasan 2	Elbasan 3	Elbasan 1	Elbasan 2	Elbasan 3
	µg/m³	µg/m³	µg/m³	µg/m³	µg/m³	µg/m³
2001	279			127		
2002	366			175		
2003	266			117		
2004	244			112		
2005	249			113		
2006	179			79		
2007		176	195	91	81.5	91
2008		138.65			56.16	
2009		121.5			61.15	
2010		118	168		58.25	81.29
2011		156.48	178		78.24	89
2012				87.63		
Norma AL	140	140	140	70	70	70
Norma KE	80	80	80	40	40	40

Tabela - Përbajtja e grimave të respirueshme PM10 në ajër



### Qarku i Elbasanit

Tabela Tabelat e Monitorimit të ajrit

Nr.	Burimet e ndotjes	Pikat e monitorimit	Koordinatat	
			Lindje	Veri
1	Kombinati Metalurgjik Elbasan	M1	0416879	4548837
		M2	0416787	4548564
		M3	0416152	4548120
		M4	0418035	4550240
		M5	0419188	4549669



		M6	0416952	4548082
		M7	0415844	4547402
		M8	0415094	4546910

Tabela Nr 41. Karakteristikat fiziko-kimike të tokave pranë objekteve industriale

Nr.	Burimet e ndotjes	Pikat e monitorimit	pH (H <sub>2</sub> O)	Humusi	Përbërja mekanike			Tekstura
					Rërë %	Lym %	Argjilë %	
	Kombinati Metalurgjik Elbasan	M1	8.1	1.85	25.2	52.0	22.8	ZL
		M2	8.3	1.58	30.4	48.0	21.6	L
		M3	8.2	2.57	14.0	60.8	25.2	ZL
		M4	8.1	2.05	44.0	35.2	20.8	L
		M5	7.9	2.89	9.2	53.2	37.6	ZCL
		M6	7.9	2.26	11.4	56.6	32.0	ZCL
		M7	7.9	1.95	15.2	35.6	49.2	C
		M8	8.1	2.73	10.8	63.8	25.4	ZL

Tabela Monitorimi i cilësisë së ajrit urban në qendër të qytetit Elbasan për periudhën Janar-Nentor 2014

Nr.	Stacionet	PM <sub>10</sub> µg/m <sup>3</sup>	NO <sub>2</sub> µg/m <sup>3</sup>	O <sub>3</sub> mesatare 8 orare µg/m <sup>3</sup>	SO <sub>2</sub> µg/m <sup>3</sup>	CO µg/m <sup>3</sup>	Benzene
1	Elbasan qendër	49,13	34,72	23,7	13,72	0,7	
2	Elbasan kombinat (Mqedisi tek RSA)	61,97	7,03	37,44	31,94	0,55	2,44
3	Elbasan kombinat Mqedisi tek DOKO	38	6,16	22,24	20,72	0,65	1,75
4	Normat shqiptare	60	60	65	60	2	5
5	Standarti i BE	40	40				5

Qyteti	Pikat e kampionimit	Periudha Maj-Qershori 2015	Periudha Maj-Qershori 2015	Periudha Gusht-Shtator 2015	Periudha Gusht-Shtator 2015	Periudha Nentor-Dhjetori 2015	Periudha Nentor-Dhjetori 2015
		Nox µg/m <sup>3</sup>	O <sub>3</sub> µg/m <sup>3</sup>	NOx µg/m <sup>3</sup>	O <sub>3</sub> µg/m <sup>3</sup>	NOx µg/m <sup>3</sup>	O <sub>3</sub> µg/m <sup>3</sup>



	DSHP Rr e Elbasanit	32,6	51,3	38,9	53,6	17,77	58,35
	Bradashesh	39,7	51,2	41,5	55,8	30,06	58,88
	DSHP	40,1	49,3	40,9	53,2	28,14	56,97
	Rruga Rinia	41,8	41,5	36,8	54,8	27,18	59,99

Tabela Standartet shqiptare krahasuar me ato të BE

PM10 ug/m <sup>3</sup>	PM2.5 ug/m <sup>3</sup>	NO <sub>2</sub> ug/m <sup>3</sup>	O <sub>3</sub> ug/m <sup>3</sup>	SO <sub>2</sub> ug/m <sup>3</sup>
Norma shqiptare	60	15	60	65
Standarti i BE	40	25	40	-

#### Vlerat e ajrit për Elbasanin, 2015 AKM

Tabela Llojet e ndotjes

Viti 2015	SO2	O3	CO	NO2	PM10	PM2.5	Benzene	% Viti 2015
Elbasan	7.7	36.46	0.6	23.36	43.41		0.63	PM10 tejkalim 9%

Tabela Vlerat 8 orare të O<sub>3</sub> në stacionin Elbasanit





Tabela Vlerat 8 orare të CO në stacionin e Elbasanit





Kemi përmirësim të këtij treguesi në stacionin e Elbasanit me 3%

#### MONITORIMI I NDOTJES ATMOSFERIKE NGA METALET TOKSIKE DHE IDENTIFIKIMI I BURIMEVE KRYESORE TË NDOTJES NËPËRMJET ANALIZËS ELEMENTARE TE AEROLSOLEVE (IFZB)

Duhet theksuar se monitorimi i mësipërm, për arsyte teknike, është 6 mujor, (Instituti i fizikës bërthamore)

Stacioni në qendër të Elbasanit nga të dhënat e paraqitura rezulton:

- Vlera mesatare gjatë periudhës se monitorimit prej  $50.6 \mu\text{g}/\text{m}^3$  është e afërt me normën e lejuar prej  $50 \mu\text{g}/\text{m}^3$ .
- Vlera mesatare mujore e PM<sub>10</sub> tregon tendencë zvogëluese kur kalojmë nga periudha e dimrit në atë të pranverës.
- Numri total i ditëve me vlerë të PM<sub>10</sub> më të lartë se norma është 42 që i takon 45.2 % të ditëve të monitorimit, ndërkohë që duhet të ishte më i vogël se 10%.

Në këto kushte gjendja e ndotjes me fraksion PM<sub>10</sub> në stacionin në qendër të Elbasanit mund të konsiderohet afër gjendjes normale por me tendenca përkqësimi, pasi numri i ditëve me tejkalim të normës është mjaft më i madh se normat e lejuara. Kjo mund të vijë ndoshta nga trafiku i lartë në zonën pranë stacionit. Krahasimi me vlerat e matura gjatë viteve të mëparshme nuk mund të kryhet për shkak se nuk disponohen të dhëna të tilla.

Tabela Variacioni ditor i vlerave të fraksionit PM<sub>10</sub> në stacionin Elbasan qendër




Tabela Variacioni mujor i vlerave të fraksionit PM<sub>10</sub> në stacionin Elbasan, qendër






Tabela Nr. 50 Variacioni mëjor i ditëve me tejkalim të normës PM<sub>10</sub> në stacionin Elbasan




Tabela Të dhëna mbi përbërjen elementare ( $\mu\text{g}/\text{m}^3$ ) të frakzionit PM<sub>10</sub> të mbledhur në stacioni Elbasan qendër, Janar – Qershor 2015

	S	Cl	K	Ca	Fe	Mn	Ti
Max	2.655	2.070	1.621	10.909	5.398	0.203	0.315
Min	0.027	0.010	0.209	0.184	0.081	0.026	0.058
Mesatare	1.115	0.249	0.739	3.208	1.115	0.063	0.120
N>0	87	38	92	93	93	71	45

	Ti	Cr	Mn	Ni	Cu	Zn	Br	Sr	Pb
Max	0.315	0.097	0.203	0.063	0.075	0.488	0.040	0.029	0.085



Min	0.058	0.029	0.026	0.001	0.001	0.006	0.010	0.011	0.003
Mesatare	0.120	0.053	0.063	0.019	0.016	0.075	0.015	0.018	0.019
N>0	45	29	71	75	73	88	32	8	58
Vlera limit		0.5	2	5					1

Nga këto rezultate vihet re se:

- Vlerat mesatare dhe ekstremale të përbajtjes së metaleve të normuar (Cr, Mn, Ni, Pb) në mostrat PM<sub>10</sub> të stacioneve në Elbasan janë mjaft më të ulëta se normat e lejuara.
- Është për t'u theksuar se vlerat e disa elementeve të matura në Elbasan gjatë kësaj periudhe janë më të ulëta se ato të matura në periudhat e mëparshme. Pamundësia për të inspektuar stacionin në Elbasan pengon të identifikojmë shkaqet e këtij ndryshimi.
- Variacionet e përbajtjes së elementeve në mostrat e matura pasqyrojnë natyrën e burimeve që mbizotërojnë në secilën zonë, të cilat evidentohen në mënyrë më të plotë në përfundim të kohës së monitorimit.

#### Vlerësimi i ndotjes në stacionet e monitorimit

##### - Fraksionet PM

Tabela Nga të dhënat e paraqitura rezulton se vlerat e PM<sub>10</sub> gjatë periudhës së monitorimit paraqiten si më poshtë:

Stacioni	Vlera mesatare Janar – Qershori ( $\mu\text{g}/\text{m}^3$ )	Tejkalimi i limitit
IFBZ – PM <sub>10</sub>	35.9	17.5 % (10/57 ditë)
IFBZ – PM <sub>2,5</sub>	21.7	75.4 % (43/57 ditë)
Elbasan, qendër – PM <sub>10</sub>	47.1	38.4 % (43/112 ditë)

Tejkalime si të vlerës mesatare ashtu dhe të numrit të ditëve me përbajtje më të lartë se limiti i lejuar ( $15 \mu\text{g}/\text{m}^3$ ) vihen re edhe për fraksionin PM<sub>2,5</sub> të matur tek stacioni IFBZ.

#### Tokat

Vlerësimi i ndotjes së tokave bujqësore pranë objekteve industriale (realizuar nga QTTB)

Foto Nr .32 Pamje e zonës së ëish Kombinatit Metalurgjik ku ka ndotje të tokave







Tabela Të dhëna për ndotjen

Nr.	Burimet e ndotjes	Zn	Mn	Ni	Cd	Cr	Cu	As	Pb	Fe
1	Kombinati Metalurgjik Elbasan	121.7	547.5	<b>478.5</b>	2.2	<b>573.0</b>	<b>452.1</b>	0.0	<b>380.3</b>	4.3
2	Uzina e Superfosfatit Laç	159.5	780.6	<b>271.5</b>	2.7	<b>359.8</b>	75.9	0.0	290.0	2.2
3	Uzina e PVC -Vlorë	90.2	271.7	69.0	1.7	170.3	44.8	0.0	121.8	2.1
4	Uzina e Baterive Berat	117.1	286.5	70.2	1.3	189.0	49.0	1.0	98.3	1.3
5	Uzina e Plasmasit Lushnje	114.6	147.8	73.4	1.2	184.9	41.5	0.9	81.2	1.3
6	Fabrika e Letrës Lezhë	162.5	925.0	<b>335.8</b>	1.8	<b>207.5</b>	78.0	0.0	109.8	1.9
7	Miniera e Hekur-nikelit Pogradec	123.7	972.5	<b>3237.4</b>	1.8	<b>329.2</b>	<b>468.7</b>	0.0	<b>398.7</b>	5.1
8	Miniera e Hekur-nikelit Prrenjas	118.2	888.2	<b>3455.7</b>	2.0	<b>329.4</b>	<b>467.8</b>	0.0	<b>390.2</b>	6.3
9	Miniera e Kalimashit Kukës	299.0	619.0	<b>474.0</b>	3.0	<b>342.0</b>	<b>342.0</b>	0.0	205.0	3.0
10	Uzina e bakrit Kukës	272.3	588.7	<b>447.7</b>	2.3	<b>319.7</b>	<b>307.0</b>	0.0	234.0	2.9
11	Uzina e ferrokromit Burrel	51.3	294.1	<b>306.9</b>	2.8	<b>684.6</b>	<b>187.6</b>	0.0	299.3	2.5
12	Uzina e Plehrave Azotike Fier	90.7	178.3	74.1	1.0	189.7	44.8	1.0	93.1	2.0
	Limitet e lejuara	300	1000	75	3	200	140	1.5	300	20





### Vlerësimi i ndotjes së tokave bujqësore pranë objekteve industriale

#### Ndotja e tokave pranë Kombinatit Metalurgjik Elbasan

Studimi fushor përmarrjen e mostrave të tokës u realizua me 12.07.2014. Për analizimin e nivelit të ndotjes nga metalet e rënda në këtë zonë janë përçaktuar 8 pika monitorimi në drejtimin verior, lindor dhe jugperëndimor të objektit industrial. Pika e parë është marrë rrëth 70m nga objekti ndërsa e fundit ka një distancë prej rrëth 2500 m. Tokat e kësaj zone paraqiten dobësisht dhe mesatarisht alkaline (7.9 deri në 8.3). Nga vlerësimi i përbajtjes së humusit ato paraqiten mesatare në të gjitha pikat e monitorimit. Përsa i përket teksturës së tokës ajo paraqitet e ndryshme. Në pikat 1, 3 dhe 8 tokat janë të ekuilibruara lymore (ZL), në pikat 2, 4 janë të ekuilibruara (L), në pikat 5, 6 janë të ekuilibruara lymore argjilore (CL), ndërsa pika 7 është argjilore (C). Në lidhje me përbajtjen e nikelit, kromit, bakrit dhe plumbit nuk ka ndonjë rregullsi me rritjen e largësisë nga objekti. Të dhënrat e analizuara treguan se përqëndrimet e zinkut, manganit dhe kadmiumit janë poshtë vlerave të përçaktuara kritike nga BE. Të gjitha tokat ku u morën mostrat janë të mbjella me kultura bujqësore. Ato janë të kultivuara kryesisht me jonxhë, grurë, misër dhe pemë frutore. Lartësitë mbi nivelin e detit variojnë nga 86 në 109m.


Tabela Burimet e ndotjes

Burimet e ndotjes	Zn	Mn	Ni	Cd	Cr	Cu	As	Pb	Fe
Kombinati Metalurgjik Elbasan	121.7	547.5	478.5	2.2	573.0	452.1	0.0	380.3	4.3
Limitet e lejuara	300	1000	75	3	200	140	1.5	300	20

#### Gjendja:

Ndotja me metale të rënda në tokat përreth zonave industriale ka rezultuar shkatërruese si përtokt bujqësore ashtu dhe për pyjet dhe kullotat.

- Niveli i zhurmave në zonën e studiuar për hartimin e raportit të thelluar të VNM-së



---

## Zhurmat

### Metotologja e matjeve

Metodologja e matjeve bëhet konform direktivave të CE dhe OSH.

Ligji shqiptar Nr. 9774, dt 12. 07. 2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjeshtë". Directive 2002/49/EC of the European Parliament and of the council of 25 June 2002. ISO 1996-2: 1987 Guidelines for Community Noise, EHO.

Aparati i përdorur është i tipit Sound Level Meter EXTECH 407764 RS-232 /Datalogger me një korigjim  $\pm 0.5$  dB (A) dhe si kalibrator OSHA Tip GenRad 1562-A.

Programi i monitorimit të zhurmave urbane per qytetin e Elbasanit dhe per zonen perreth nuk ka por aktualisht ne po japim ato qe jane matur nga subjektet private

**Niveli i zhurmave në zonën e studiuar për hartimin e raportit të thelluar të VNM.**

Në zonën e studiuar, nuk ka monitorim të nivelit të zhurmave, kjo zonë nuk vlerësohet ndër problematiket në këtë drejtim. Shkaqet e mundshme të shkaktimit të zhurmave në këtë zone janë aktiviteti i zones industriale. Ne nje testim te nivelit te zhurmës ne objekt, rezulton se niveli maksimal varion rreth 68 dBA.

Duke qenë se është zonë industriale, zhurmat janë të pranishme gjatë fazës së shfrytëzimit të objektit. Gjatë fazës së prodhimit të gazit sulfuror, zhurmat nga automjetet janë një ndikim që duhet të merren në konsideratë, ato janë tëvazhdueshmeedhe pse minimale.

Në zonën në studim ka monitorime të realizuara në zonën industriale.

Tabela Vlera e emetimit të zhurmave nga automjetet.

Paisja	Vlerat
Uzina 12	58-68 Leq dB(A) ne 15m
Në hyrje të kombinatit ku kalojnë kamiona	55- 76-78 Leq dB (A) ne 15 m

Zhurmat në objektin që shfrytëzohet për prodhimin e SO<sub>2</sub>do të shkaktohen nga transportidhe nga procesi teknologjik, prandaj shoqëria duhet të përdori teknologjinë e fundit tëpaisjeve prodhue të gazit sulfuror për të ulur vibrimet dhe nivelin e zhurmave.

### - Administrimi i mbetjeve në zonën ku propozohet projekti

- Gjate vitit 2016-2017 eshte ndertuar landfilli i ri ne Elbasan se bashku me Incineratorin e mbetjeve urbane**

Nxitja e Partneritetit Publik-Privat

Në bazë të nenit 65, të ligjit 10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", projektet që në gjykimin e ministrisë, synojnë të realizojnë masat e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, jepen me koncesion. Kështu nëpërmjet dhënieve me koncesion do të ndërtohet landfilli për qarkun e Durrësit, ka filluar ndërtimi i inceneratorit të Elbasanit. Gjithashtu, do të vazhdojë të jepen me koncesion edhe menaxhimi i rrymave të tjera të mbetjeve. Aktualisht perfundoi ndërtimi inceneratorit të mbetjeve urbane të qytetit të Elbasanit dhe është realizuar mbyllja e rehabilitimi i Shesh-depozitimit ekzistues të mbetjeve të ngurta urbane.

Objektivat dhe produktet madhore në fushën e mbetjeve për periudhën 2015-2020 janë të parashikuara në mënyrë të detajuar ne Strategjinë dhe Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve.



---

- Rritja e sasisë së mbetjeve që shkojnë në landfill në masën 45% ; -riciklimi dhe kompostimi i mbetjeve urbane në masën 55 %; - zbatimi i planeve të rehabilitimit për 9 hyspotet prioritare dhe hartimi i planeve për hotspotet e mbeturat.

#### Përfundim

**Gjëndja:** gjenerimi i mbetjeve për vitin 2016 është afersisht 0,9 kg për person në ditë ose në total 971565 ton. Sasia e mbetjeve të riciklueshme të eksportuara për vitin 2013 është 35 055 ton. Mbetet shumë për t'u bërë për të arritur objektivat në fushën e mbetjeve si për uljen e gjenerimit të mbetjeve dhe për zbatimin e hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve.

Trendi: Nga viti 2012 gjenerimi i mbetjeve në total ka ardhur duke u ulur ,si gjenerimi i mbetjeve bashkiake ashtu dhe i mbetjeve inerte, kjo falë politikave që janë zbatuar . Ndonëse në shifra shumë të vogla por kanë filluar të shtohen aktivitetet që merren me riciklimin e mbetjeve .

- Gjatë vitit 2016 kemi ulje të gjenerimit të mbetjeve në total (urbane dhe inerte) krahasuar me vitin 2015. Sasia e mbetjeve urbane dhe mbetjeve inerte është ulur.
- Problem mbetet mungesa e sistemit të grumbullimit dhe depozitimit të mbetjeve urbane në zonat rurale.
- Mbetjet industriale të trashëguara nga e kaluara dhe depozituara në disa depo të vendit janë prioritare për trajtimin, shitjen dhe përdorimin si dhe asgjësimin e tyre nëpërmjet teknologjive të pastra.

Masa:

- Vendosja e një inceneratori në afersi të ndonjë prej fabrikave të çimentos për djegien e mbetjeve të rrezikshme dhe urbane për shfrytëzimin e energjisë së prodhuar për qëllime industriale të prodhimit.
- Sigurimi i fondeve dhe riaftësimi gradual i zonave industriale të ndotura ( hot – Spote) të identikuara të vendit, të cilave u janë përfunduar projektet e studimit.
- Hartimi i aktit nënligjor për menaxhimin e mbetjeve inerte
- Përmirësimi i sistemit të monitorimit, informacionit dhe regjistrimit të të dhënavëve.

Rekomandime:

- Zbatimi i Planit të Menaxhimit të mbetjeve 2010-2025.
- Krijimi i strukturave administrative në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal për forcimin e mëtejshëm të administrimit të mbetjeve;
- Ndërgjegjësimi i publikut për ndarjen dhe grumbullimin selektiv të mbetjeve urbane.


- Probleme të tjera (nëse evidentohen), të tillë si: erozioni i tokës, zjarret, ndotje historike etj

Tabela Vleresim teorik për nivelin e erozionit potencial në tokat bujqësore të Shqipërisë.



Rrethet	Sip (Ha)	Indeksi i erodibilitetit		Indeksi i erozivitetit	Indeksi i përcisise	Indeksi i rrezikut potencial të tokës		
		Absol.	Rel.			Absol	Rel.	Vleresimi
Korce	58973	6.3	3	2	1.68	10.1	2	Mesatar
Lezhe	15461	6.7	3	3	1.12	10.1	2	
Lushnje	46136	5.7	2	2	1.60	6.4	2	
Durres	47076	5.1	2	2	1.57	6.3	2	
								16764 6 ha
Diber	23315	7.5	3	2	2.04	12.2	3	Harte
Elbasan	40450	6.9	3	2	2.25	13.5	3	
Fier	60674	6.7	3	3	1.68	15.1	3	

Struktura e tokës bujqësore



Erozioni është një fenomen natyror që kë të bëjë me gjërryerjen, ç'vendosjen dhe transportin e lëndëve të ngurta ose materialit tokësor kryesisht nën forcën e veprimit të ujit, akullit ose erës. Erozioni vepron në kundërshtim me ekuilibrin natyror të ekosistemeve. Nevojitet një kohë shumë e gjatë për të kompensuar humbjen e lëndës të shkaktuar nga erozioni për një kohë fare të shkurtër. Ai ngelet një rrezik serioz për tokën në Shqipëri. Ndryshimet klimaterike shpesh shfaqen me çrrregullime në sasinë dhe intensitetin e reshjeve duke kontribuar në shkallën e erodimit të tokës.

Masat e luftës kundër erozionit synojnë parandalimin e rreziqueve për mjedisin ose konservimin e burimeve jetësore. Parandalimi dhe kufizimi i erozionit është i lidhur direkt me përmirësimin e kushteve të mjedisit dhe në afatgjatë ndikon drejtëpërdrejtë cilësinë e jetesës.

Erozioni vazhdon të ketë të njëjtën tendencë nëvartësi të kushteve klimatike, saisisë dhe intensitetit të reshjeve. Vazhdon të evidentohet fakti se manaxhimi i pyjeve nga komuniteti në zbatim të politikës së Qeverisë Shqiptare dhe Bankës Botërore ka sjellë uljen e nivelit të prerjeve të pyjeve duke kontribuar në përmirësimin e situatës dhe në mbrojtjen e tokës. Situatë aktuale bën të nevojëshme të ndërmerrret një studim i posaçësm me qëllim hartimin e një Planit Veprimi për Menaxhimin e Erozionit.



---

Të dhënat teorike tregojnë së në rreth 167. 646 ha ose 25% të tokave bujqësore reziku potencial është mesatar ndersa në rreth 442. 200 ha ose 75% të tokave reziku është i lartë. Nisur nga përbërja grimcometrike (tekstura) tokat më të predisposuara ndaj erozionit janë ato të Vithkuqit dhe Radhimës dhe më pak të predispozuara janë ato të Lezhës dhe Librazhdit. Faktori bimor është marrë në nivele të ndryshme i pa mbrojtur nga bimësia (tokë ushqar), bimë prashitëse, me mbrojtje mesatare (bimë të lashta), dhe me mbrojtje të lartë (bimë livadhore).

#### Dëmtimi i pyjeve nga Zjarret

Ne zonen qe jemi nuk ka probleme

- Presionet kryesore të mjedisit në zonën e projektit (si: ndotjet e mjedisit, prerje pyjesh etj.)

Në këtë zonë identifikohen aktivitete që mund të ushtrojnë presion mbi mjedisin e zonës. Këto janë aktivitetet industriale të zonës Industriale të Kombinatit Metalurgjik. Ky aktivitet, pritet të ketë impakte në mjedis, por jo në aspektin e erozionit apo të demtimit të mjedisit biologjik. Impakti nga çlirimi i Gazit SO<sub>2</sub>, ndikon në shtimin e gazeve të dëmshëm për atmosferën dhe efektin serrë shkaktar të ngrohjes globale, por në nivele jo të larta dhe problematike. Një imapkt tjeter mund të konsiderohet shkarkimi i ujërave të sistemit ftohës, këto ujra në temperaturë më të lartë se mjedisi i zonës, ndikojnë në dëmtimin e florës dhe faunës ujore të mjedisit ujor në të cilin ato shkarkohen. Megjithatë, duke qenë se ky ujë kalon në sistem kanalizimesh e dekantimi dhe bashkohet me kolektorin kryesor të zonës industriale të Kombinatit Metalurgjik, nuk ka imapkt të drejtperdrejtë në rritjen e temperaturës së ujit, pasi koha e nevojshme deri në shkarkimin e tij bën që të ftohet uji deri në arritjen e tij nëburimin ujor pritës.

#### 4.4 Përshkrim i karakteristikave sociale të zonës ku propozohet projekt:

Per zonen ne studim nuk disponojme te dhena per gjendjen ekonomike e sociale, por si ne shume zona te vendit, pritshmerite jane per një zone te pa zhvilluar ekonomikisht dhe qe burimi kryesor i te ardhurave jane blegtoria, bujqesia dhe emigracioni (persa i perkete fshatrave), ndersa vendbanimet ne qytet dhe rrithinat e tij, jane te lidhura edhe me industrine e marredheniet tregtare brenda dhe jashte vendit. Gjendja ekonomike e sociale paraqitet e dobet dhe kjo zone ka nevoje per investime e zhvillim te resurseve natyrore, por sigurisht ne harmoni mje mjedisin biologjik, fizik dhe ate social ekonomik te zones.

Relativisht popullsia e Elbasanit eshte ne gjendje ekonomike mesatare. Kohet e fundit zona ka njobur një zhvillim te lehte te industrise dhe sipermarrjes private, por edhe keto te fundit jo me potencial te larte zhvillimi e ekonomik. Ky aktivitet perfaqeson një burim te rendesishem te ardhurash per pak banore te zones.

Tabela Nr. 60 Informacion per qendrat e banuara




### QARKU ELBASAN

Nr.	Njësi të qeverisjes vendore			Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
	Qarku	Qendra e Qarkut	Bashkia			
IV.	Elbasan	Qyteti Elbasan	Elbasan	Qyteti Elbasan	Elbasan	Qyteti Elbasan
					Labinot-Fushë	Fshatrat, Labinot-Fushë, Godelesh, Guqan i Spërm, Guqan i Poshtëm, Nisake, Mengel
					Labinot-Mal	Fshatrat, Labinot-Mal, Guri Zi, Seicë, Lamës, Benë, Lagasta, Qafë, Qeret, Shund, Dritë
					Gjinar	Fshatrat, Gjinar, Leshan, Valesh, Pashtresh, Derstë, Luku, Shtëfan, Xabesh, Melkuth, Kafet, Pobrat
					Shushicë	Fshatrat, Shushicë, Shëllcan, Mbëz, Hujdura, Fush-Bull, Vërap, Poli i Vogël, Poli Vak, Veshtrij
					Gjergjan	Fshatrat, Gjergjan, Bujarës, Gjoma, Kastrijello, Kodra Bujarës, Muqan, Thunë
					Funar	Fshatrat, Boçesh, Boçelle, Peç e Spërm, Cerni, Kozë, Mollagjesh, Kurbë e Vogël, Preç e Poshtme, Stafë
					Shirgjan	Fshatrat, Shirgjan, Butxes, Bujën, Jugoçanë, Kuqan, Kryerpar, Melës
					Tregan	Fshatrat, Tregan, Bletinë, Buzëfui, Çoflesh, Gurjat, Kicivel, Kryek, Mocan, Shanvalash, Shiftezi, Trepëndit, Toda
					Gracen	Fshatrat, Gracen, Flangarë, Tërbag, Bedin, Shangjin, Gjom, Pajçuge, Mançk, Dupci
					Bradashesh	Fshatrat; Bradashesh, Bajë Liri, Bajë Poshtë, Kozarë, Kozin, Kuklik, Letia, Rukë, Shtemaj, Ulen, Kukundi i Ri, Fikas, Petreth, Shembull, Shijon, Reçan, Gushashlli
					Zavalinë	Fshatrat, Zavalinë, Selë, Kamicaj, Jocoshë, Nezha, Bourichtë
					Papër	Fshatrat; Papër, Brodëk, Mullas, Valas, Vellaz, Pajun, Buzëz, Papër-Sallëk, Vullas-Hargjel, Luga, Jateli, Balldice, Ulthataj

- Informacionin për qendrat e banuara, në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, Qendra e banuar me e afert e rajonit eshte Fshati Bradashesh, Fshati Vidhas, Fshati Bujqes dhe me tej Qyteti Elbasanit. Qendra me e afert e banuar eshte vete Bradasheshi, ku distanca ne vije ajrore me objektin eshte rrëth 1.5km ne drejtim te veriut, ndersa fshati Vidhas ndodhet rrëth 2.5km larg, ne drejtim perendimor. Qyteti i Elbasanit ndodhet ne verilindje, rrëth 5km larg ne vije ajrore. Ne lidhje me zonen industriale, ky objekt ndodhet pothuajse ne qender te saj.

Foto Harta me largësinë e objekteve nga qendrat e banuara dhe ujrat e Lumit Shkumbin



- Njësie e qeverisjes vendore që administron zonën ku zbatohet projekti




---

Njësia e qeverisjes vendore që administron zonën ku zbatohet projekti është Bashkia Elbasan, Njësia Administrative Bradashesh. Me hyrjen në fuqi dhe zbatimin e ligjit tëri nr. 115/2014 datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, kjo Njësi Administrative, nga Komuna Bradashesh, kaloi në administrim të Bashkisë Elbasan me qendër në Elbasan qytet.

**Njësia Administrative Bradashesh është pjesë e Bashkisë Elbasan.** Ajo ndodhet në pjesën qendrore të Shqipërisë, në perëndim të qytetit të Elbasanit, në fushën me të njëjtin emër. Relievi është tipik fushor e kodrinor i thyer, por me maja të buta. Kodrat ndodhen në krahun e majtë të përroit të Kushës me: Kodrat e Kusarthit, Balzës (ku shtrihet fabrika e Çimentos), Gurabardhit, Karakullakut (veshur me dushk), Kozanës, maja e Fungut, maja e Cirrumullit. Në të djathtë të përroit të Kushës deri tek përroi i Kalicovës ngrihet grupei i kodrave të Bradasheshit-Fikas (të veshura me ullinj e siq) e të Shijonit. Grupi i fundit i kodrave është ai që fillon nga Balldreni – Jatesh – Shënmhill. Hidrografia përbëhet nga përroi i Kushës me degët e tij, përroi i Kalicovës etj. Territori i Njësisë Administrative Bradashesh ka burime nëntokësore, ujmëbledhëse. Në këtë territor ka dhe monumente të natyrës si: Kalaja në vendin e quajtur **Shkëmbi i Skënderbeut** (Sh. Lliut) në fshatin Petresh e shpallur si monument kulture në vitin 1973. Ajo ndodhet 14 Km larg Elbasanit. **Stacioni rrugor Ad – Quintum** ndodhet në fshatin Bradashesh. Eshtë në gjendje të mirë për t'u vizituar dhe ndodhet buzë rrugës nationale.

Foto Pamje e Stacionit rrugor Ad - Quintum



Ky stacion është ndërtuar në shekullin II të pas Krishtit përgjatë rrugës Egnatia për t'i shërbyerudhëtarëve. Ai përbën një kompleks së bashku me ninfeun të vendosur në një sipërfaqekatërkëndëshe 45 x 12 metra. Numri i vendeve për të shërbyer është i vogël por përbëmbajnë të gjitha kthinat kryesore, dhomat e zhveshjes, ambientin e ngrohtë, ambientin e nxehë dhe ai meujë të stohtë. Banjot e këtij stacioni kanë një zgjidhje racionale planimetrike dhe estetike.

#### **Kisha e Shën Gjon Vladimirit në fshatin Shëngjon.**

Në afersi të rrugës Egnatia, në një nga degëzimet e saj që tëçon në drejtim të Petrelës ndodhet Manastiri **Shën Gjonit**. Gjon Vladimiri, princ i Krajës, i cili u vra në Prespë kundër bullgarëve më 4 Qershor 1016. Kisha është e vizitueshme dhe ndodhet 5 km nga Elbasani.




Foto Pamje e Kishës së Shën Gjon Vladimirit




**Peisazhi.** Njësia Administrative Bradashesh, Bashkia Elbasan, karakterizohet nga struktura specifike gjeografike, ku përfshihet mjedisi fizik, përbërja biologjike dhe strukturat njerëzore e sociale. Ajo rrrethohet në pjesën veriore dhe veriperëndimore me masivin e ullishtës dhe Kodrën e Krrabës të pyllëzuar, në lindje me banesa të qendrës së qytetit të Elbasanit, në jug me lumin e Shkumbinit të cilat harmonizohen midis tyre.

Në të gjitha këto pamje, ekosistemet natyrore, pylli, lumi, kodrat me ullinj, fushat, grupohen dhe kombinohen me peisazhin kulturor, krijuar nga veprimitaria njerëzore. Në tërësinë e tij, peisazhi natyror i zonës ku realizohet aktiviteti për "Prodhimin e Dioksidit të Squfurit të Lëngët" i lë veprim të lirë peisazheve urbane që harmonizohen me peisazhet bujqësore të përdorura intesivisht në ultësirën perëndimore të Bradasheshit.

Foto : Pamje nga Njësia Administrative Bradashesh, Bashkia Elbasan





Njësia Administrative Bradashesh përfshin 17 fshatra. Bradashesh, Balëz Lart, Balëz Poshtë, Kusarth, Kozan, Karakullak, Letan, Rrilë, Shtemaj, Ulën, Katund i ri, Fikas, Patresh, Shënmëhill, Shingjon, Reçan, Gurabardhë. Popullsia sot numuron 12642 banorë. Shtrihet në një sipërfaqe prej 55,2 km<sup>2</sup>. Drejtimi kryesor i ekonomisë ka qenë prodhimi i drithrave të bukës dhe rritja e lopëve dhe të dhenve. Sipërfaqja e tokës bujqësore është 1600 ha dhe sipërfaqja e pyjeve dhe kullotave është 2092 ha. Sot aty veprojnë 93 biznese. Ka 9 kopshte fëmijësh, 8 shkolla fillore, 7 shkolla 9-vjeçare. Popullsia e zonës është vendase, por ka të ardhur nga zona të tjera, sidomos nga malësia e Martaneshit. Eshtë e banuar që në kohërat e vjetra dhe ka monumente kulture si: Stacioni At Quintum që është trakt i rrugës Egnatia, Manastiri i Gjon Vladimirit (i kohës bizantine), çezmja e Kasinës, etj. Në këtë njësi administrative të Bashkisë Elbasan ka disa monumente kulture interesantedhe të bukura për përt'u vizituar.

#### - Përdorimi i tokës në zonën e projektit

Përdorimi i tokës në këtë rajon është kryesisht në aspektin bujqësor e blegtoral. Zonat malore përdoren për qëllime kullote, zonat pyjore, si dhe në afërsi të fshatrave për qëllime bujqësore. Pjesa e kombinatit Metalurgjik, është e gjithë në përdorim nga industria e rëndë dhe ajo e lehtë prodhuese dhe përpunuese qëështë ngritur në këtë territory vitet e fundit. Një pjesë e vogël e tokës është përdorur për gjelberimin e rrugëve të brendëshme të zonës industriale.

#### 5. Përshkrimi i ndikimeve negative të rëndësishme të projektit të propozuar mbi mjedisin ku përfshihen:

##### 1.1 Ndikimet negative në mjedis:

Vlorësimi i ndikimeve të mundëshme si pasojë e veprimtarisë bëhet duke u nisur edhe nga një faktorësh që lidhen me natyrën e veprimtarisë si: teknologjinë e përdorur, mënyrën e operimit, sasia e energjisë, mbetjet e gjeneruara, biologjike dhe social-ekonomike.



---

Procesi për "Prodhimin e Dioksidit të Sufurit të Lëngët, SO<sub>2</sub>" shoqërohet me ndikime mjedisore. Për nga natyra e veprimitarise dhe mënyra se si është parashikuar shfrytëzimi i objektit, ndikimet mund të analizohen sipas fazave të veprimitarise dhe konkretisht:

- Në fazën e lëvizjes së lëndës së parë për prodhim
- Në fazën e procesit të prodhimit të SO<sub>2</sub> të lëngët
- Në fazën e prodhimit të SO<sub>2</sub> të gaztë
- Në fazën e mbushjes së bombolave me SO<sub>2</sub>
- Në fazën e transportit të materialit të prodhuar dhe shërbimit të zonës së industrisë.

**- Zonat e ndjeshme ndaj ndikimeve të projektit (zona të mbrojtura dhe habitate, qendra të banuara, burime ujore, zona arkeologjike etj.)**

Në këtë zonë nuk identifikohen zona të mbrojtura ose zona të ndjeshme mjedisore. Burimi ujor i cili preket nga aktiviteti industrial në terësi për këtë zonështë Lumi Shkumbin, i cili sipas analizave dhe matjeve të kryera nga raportet vjetore të Ministrisë së Mjedisit, rezulton të jetë i kontaminuar dhe mbi normat e lejuara të elementeve përbërës.

**6. Ndikimet në mjedisin ndërkuqitar të projektit (nëse ka të tilla)**

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhojë edhe ndikimi i tij nuk shkakton dëmtim të mjedisit ndërkuqitar. Për këtë kapitull, nuk kryhen vlerësimi dhe analiza të detajuara për shkak të vendodhjes së projektit në brendësi të kufirit shtetëror dhe distancës që ai ruan me kufirin dhe shtetet fqinje.

**7. Ndikimet pozitive në mjedisin e zonës së projektit**

Ndikimet pozitive të këtij projekti ne mjedisin e zonës konsistojnë në aspektin social-ekonomik. Këto ndikime ndikojnë sado pak në rritjen e punësimit, përmirësimin e infrastrukturës së zonës industriale, rritjen e të ardhurave të njësive të qeverisjes qendrore dhe vendore nëpërmjet taksave dhe tatimit, si dhe zhvillimin e vendit duke investuar në aktivitete e biznese të ndryshme. Këto lloj produktesh, janë nga produktet e pakta që vendi ynë eksporton dhe si rrjedhojë ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e prodhimit të brendshëm bruto.(GDP-së).

Ndikim tjetër do të jetë në aspektin social, duke zbutur efektet e emigracionit dhe të konflikteve sociale të shkaktuara nga gjendja e dobët ekonomike. Këto ndikime do të shtrihen në kohë për aq kohë sa do të funksionojë aktiviteti me kërkesën e shoqërisë "ELBAGAS"sha..

**8. Masat e propozuara për mbrojtjen e mjedisit nga secili ndikim negativ, të identikuara në paragrafin 5, më sipër.**

**Masat Zbutëse të Projektuara të Ndikimeve Negative gjatë Prosesit të Funksionimit**

Masat zbutëse të ndikimeve negative konsistojnë në marrjen e masave për uljen e ndotjeve gjatë funksionimit të instalimit në ajër, si gazrat dhe zhurma, si dhe ujrat teknologjike të stohjes menaxhimi i mbetjeve, uljen e efekteve negative hapsinore në territor, faun dhe florë. Por pëksëjimi i studimit mbetet menaxhimi i linjës së prodhimit dhe evitimi në maksimum i rrimit të gazrave në ajër dhe ujrate teknologjikë.



## **Identifikimi i masave për të eleminuar apo zbutur ndikimet negative në njedis**

Planifikimi i zonës së instalimit

Për shambahen dhe parandalimin e gjenerimit të gazrave, ujrale, mbetjeve dhe zhurmave, si dhe për ruajtjen e regjimit të linjës së prodhimit dhe prametrave inxhiniero-mekanike të saj, në projekt është përcaktuar funksionimi harmonik dhe i kombinuar në kohë dhe hapësirë i objektit në tërësi dhe i linjës së “Prodhimit të Dioksidit të Sufurit SO<sub>2</sub>”.

Në objektin ku ndodhet instalimi është parashikuar hapa pas hapi, rigjenerimi i mjedisit të brendshëm e të jashtëm, sistemimi i lëndës së parë, parkimi i automjeteve, magazinimi i pajisjeve/makinave ndihmëse dhe ngarkimi produktit të prodhuar, duke realizuar shfrytëzimin sa më eficent të mjedisit të shfrytëzuar dhe lëndës së parë nga shoqëria “ELBAGAS”sha.

Tabela Masat e propozuara për mbrojtjen e mjedisit nga secili ndikim Negativ

<i>Rekomandime për zbutjen e ndikimeve</i>	
<b>Toka</b>	
Përdorimi i Tokës	Kryerja e aktivitetit brenda koordinatave të dhëna në relacion. Respektimi i kushteve teknike dhe standardeve.
<b>Erozioni</b>	
Mbrojtja nga erozioni	Zbatimi rigoroz i masave teknike për operimin e linjës së impiantit të prodhimit. Mbjellja e fidanëve përreth perimetrit të objektit në përdorim, me qëllim mbrojtjen e kompaktësisë së tokës. Mirëmbajtja e bazamentit ku janë të istaluara linja e “Prodhimit të Dioksidit të Sufurit SO <sub>2</sub> ”.
<b>Biodiversiteti</b>	
Vegjetacioni Dëmtim potencial i vegjetacionit	Mirëmbajtja e kurorës së pemëve dhe bimësise së mjedisit në përdorim nga shoqëria. Mbjellja e fidaneve të rinj, përgjatë rrugës që bën ë mundur hyrjen për në objekt.
<b>Cilësia e ajrit</b>	
Rritje e emetimeve në ajër nga funksionimi i linjës së prodhimit dhe djegia e karburantit të automjeteve ngarkim-shkarkimit	Gazi Sulfuror mund të jetë i pranishëm në mjediset e punës, sidomos pranë furrës së oksidimit, por edhe në nyjet e ngarkim-shkarkimit të gazit ne depozitat e ambalazhit. Si rrjedhojë subjekti duhet të kujdeset për njëprocess pune dhe cikël hermetik dhe plotësish të myllur. Pajisjeve të punës dhe bombolave të ambalazhit, por edhe depozitës kryesore, duhet t'u kryhet kolaudim periodik, pranë mënyrë vazhdueshme, në mënyrë që të shmangen mundësítë e rrjedhjes së gazit apo të eksplozionit. Të kontrollohen vazhdimi i valvulat e sigurisë dhe mjedisit i punës të jetë gjithmonë i hapur e i ventilar(i mirë ajrosur).
<b>Mbetjet</b>	
Shtim i mbetjeve industriale dhe urbane nga aktiviteti human i punonjësve që do të operojnë në objekt.	Vendosja e kontenierëve në brendësi dhe jashtë objektit, diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara dhe transportimi periodik i tyre në vendepozitim më të afërt të caktuar nga njësia vendore. Asgjesimi i mbetjeve që vijnë nga impianti, nga kompani të licënsuara. Rikuperim, Riciklim dhe Ripërdorim në maksimum i mbetjeve të gjeneruara nga linja e “Prodhimit të Dioksidit të Sufurit SO <sub>2</sub> ”. Monitorim dhe inspektim i vazduhar në vendin e



	depozitimit. Në rast nevoje, të merren veprime të posaçme. Të mos hidhen mbetje në mjedisin e zonës, qofshin këto skorje apo lëndë e parë squsur. Ato të menaxhohen nga subjekti që menaxhon mbetjet e ngurta.
Ujërat e Ndotura Urbane	Përdorimi i ujit është me cikël të mbyllur, duke riqarkulluar të njëjtën sasi uji për ftohjen e linjës së prodhimit. Maksimizimi i përdorimit te ujit.
<b>Zhurmat</b>	
Rritje e nivelit të zhurmave nga impianti dhenga lëvizja e automjeteve	Përdorimi i mjeteve të kolauduara. Përdorim i linjës së prodhimit brenda orareve të caktuara, nga rregullorja e punës. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse nga punonjësit (kufje për mbrojtjen e aparatit të dëgjimit). Përdorimi i mjeteve të punës dhe të transportit gjatë orareve të përshtatshme.
<b>Trafiku rrugor</b>	
Trafiku Rrugor Rritje e fluksit të qarkullimit të automjeteve	Lëvizshmëria do të studiohet të kryhet në oraret ku shmanget piku i trafikut. Mjetet e transportit do të lëvizin brenda normave të lejuara të shpejtësisë, referuar Kodit Shqiptar Rrugor.

## 9. Programin e monitorimit të ndikimeve në mjedis gjatë zbatimit të projektit

### Qëllimet e monitorimit mjedisor

Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë.

Qëllimi i monitorimit mjedisor për linjën e “Prodhimi i Dioksidit të Squfurit të Lëngët, - SO<sub>2</sub>”, është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimitarisë është në përputhje me ligjet dhe standartet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

### Baza Ligjore e Monitorimit

Monitorimi i mjedisit është detyrim ligjor, mënyra, frekuencia dhe elementët e monitorimit janë të ndryshëm për veprimitari të ndryshme.

### Kërkesa ligjore për kryerjen e monitorimit:

Ligji nr. 10431 datë 09.06.2013 “Për mbrojtjen e mjedisit”, kreu VI “monitorim i gjendjes së mjedisit”;

Subjekti është i detyruar të kryejë monitorimet periodike sipas kërkesave të përcaktuara në kushtet e dejetës përkatëse mjedisore.

Fabiolet Baza Ligjore për monitorim



Ligji Nr.10266 datë 15.4.2010	Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
Ligji Nr. 9774 datë 12.07.2007	Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis
VKM Nr.1189 datë 18.11.2009	Për Rregullat dhe Procedurat për Hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit
VKM nr.103 datë 31.03.2002	“Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë
VKM Nr. 435, datë 12.09.2002	Për miratimin e normave të shkarkimeve ne ajër në Republikën e Shqipërisë
VKM Nr. 803 datë 04.12.2003	Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit
Udhëzimi Nr.8 datë 27.11.2007	Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara
Udhëzimi Nr. 6527 datë 24.12.2004	Mbi vlerat e lejueshme të elementëve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkarkuar nga mjetet rrugore, dhe mënyra e kontrollit të tyre. I ndryshuar me: Udhëzimin Nr. 12 datë 15.06.2010

#### Masat për rigjenerimin e mjedisit

Masat për rigjenerimin hap pas hapi, krahas “Prodhimit të Bioksidit të Sufurit, SO<sub>2</sub>” konsistonë në:

1. Krijimin e sipërfaqeve për mbjellje me bimësi
2. Mbjelljen e sipërfaqeve të reja me fidanë pishe dhe barishte të ndryshme
3. Mirmbajtjen e sipërfaqeve të mbjella
4. Kapja dhe trajtimi i gazeve që gjenerohen nga instalimet për prodhimin e bioksidit të sulfurit



## 10. Planin e menaxhimit dhe monitorimit të mjedisit

Për të shmangur dhe menaxhuar sa më mirë ndikimet negative në mjedisit të shkaktuara nga elementet e përshkruar më sipër, subjekti nëpërmjet personelit të tij do të përpilojë dhe do të zbatojë një plan efikas menaxhimi të ndikimit në mjedisit. Përbajtja e këtij plani mbështetet në këto parime të zbatueshme.

Çfarë	Si	Kush
Parandalim	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Përzgjedhja e teknologjisë plotësish të kontrolluar dhe moderne me pajtueshmëri mjedisore në fushën e teknologjisë së prodhimit të SO<sub>2</sub></li> <li>❖ Paisja e territorit të linjës dhe ambjenteve të punës me sisteme përballimi të emergjencave dhe mbrojtjen nga zjarri</li> <li>❖ Zbatimi rigoroz i rregullave të sigurimit teknik gjatë punës dhe ndërprerjes së saj duke zbatuar normat e vendosura për këtë qëllim</li> <li>❖ Përdorimi i mjeteve mbrojtëse në punë si doreza, syze mbrojtëse, rroba pune, e tj</li> <li>❖ Plotësimi i gjithë dokumentacionit figurativ që ka të bëjë me zbatimin e rregullave të manovrimit për çdo paisje, rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë si dhe atyre kundra zjarrit. Në vendet me preçedentë vendosen parrulla paralajmëruese për aktivitetin e objektit industrial.</li> <li>❖ Kontrolli mjekësor periodik i punonjësve.</li> <li>❖ Tokëzimi i të gjitha paisjeve që punojnë me energji elektrike për të shmangur aksidente me pasoja</li> </ul>	Subjekti
Kontroll	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Vendosja e rezervuarëve të ujit dhe të gjithë pajisjeve të MKZ-së</li> <li>❖ Sigurimi i të gjitha pajisjeve të nevojshme për riparim, pastrim dhe ndërhyrje në raste emergjencash</li> <li>❖ Sigurimi i ambalazhuesve të sigurt e rezistentë për mbetjet industriale</li> </ul>	Subjekti dhe stafi i tij
Ndërhyrje	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Riparim i menjëhershëm i difekteve dhe avarive teknologjike</li> <li>❖ Aktivizim i menjëhershëm i stafit dhe mjeteve të fikjes së zjarrit</li> <li>❖ Njostim i menjëhershëm i autoriteteteve dhe njësive të specializuara në rast emergjencash (zjarrfikës, autoambulanca)</li> </ul>	Personeli dhe organet shtetërore të specializuara
Administrim	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Përdorimi dhe ruajtja me përgjegjësi i të gjithë infrastrukturës dhe mjeteve të përshkruara më sipër</li> </ul>	Stafi i "ELBAGAS" sh.a

- Rolet dhe përgjegjësitë për zbatimin e secilës masë të propozuar për mbrojtjen e mjedisit në secilën fazë të projektit.

Rolin dhe përgjegjësinë kryesore të mirëmbajtjes së mjedisit e ka subjekti investitor "ELBAGAS" sha.

Institucionet përgjegjëse për mbikqyrjen e zbatimit të masave mbrojtëse, për raportimin e të dhënavë të monitorimit të mjedisit nga subjekti, etj, janë: Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Drejtoria Rajonale e Mjedisit e prefekturës Elbasan, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, Inspektorati Qendror Teknik, Komisariati Rajonal i Mbrojtjes kundër Zjarrit, Njësia e Qeverisjes Vendore(Bashkia Elbasan dhe Njësia Administrative Bradashesh), Ministria e Energijsë dhe Industrisë, si dhe vete subjekti investitor "ELBAGAS" Sha. nëpërmjet ekspertit osë subjektit kontraktor të perzgjedhur për këtë qëllim.

Tabela Monaxhimi instalimit



Kushtet e Punës								
Numri total i punonjësve	3 Punonjes							
Shpërndarja e punonjësve	ZYRA	PRODHIMI	MIRËMBAJTAJA	MAGAZINI	TË TJERA			
	2	4	I	I				
Turnet dhe aktivitetet	Zyrat / administrata	Instalimet						
Orët e punës	Zyrat / administrata	Instalimet						
	8 ore	8 ore						
Numri i ditëve të punës në vit	44							
Numri i orëve në vit	352							
Variacionet sezonale	Sipas kërkesave të porositësve të prodhimit							
Turnet dhe numri i punëtorëve për turn	Gjatë variacioneve sezonale	Pjesa tjetër e vitit						
		I turn me 8 punetorë						
Periudhat gjatë të cilave kompania mbylltet	Pushimet							
	Ndërprerje të rregullta të funksionimit							

Menaxhimi i instalimit bëhet nga një staf i kualifikuar dhe trajnuar për të operuar dhe për të ushtruar aktivitetin e “Prodhimit të Bioksidit të Sufurit SO<sub>2</sub>”, për të cilin shoqëria “ELBAGAS” Sh.a.operon në tregun e jashtëm dhe rajonal të Elbasanit. Për zhvillimin e aktivitetit të kësaj shoqërie konform të gjitha rregullave teknike, tatimore, fiskale dhe atyre mjedisore, është organizuar puna në mënyrë të tillë që të funksionojë në formën e një organogramë për realizimin sa më eficent dhe të sukseshem, e cila tregon mënyrën e funksionimit, ndarjen e detyrate dhe përgjegjësive të secilit.

#### Plani i menaxhimit të mjedisit

Çdo veprimtari e rëndësishme që kryhet në marëdhënie me mjedisin, duhet të parashikojë në projektin e saj edhe Planin e Menaxhimit të Mjedisit (PMM), qëllimi i të cilit është parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi i ndikimeve negative ndaj mjedisit të veprimtarisë që propozohet të kryhet.

#### Kualifikimi i personelit dhe masat mbrojtëse të përgjithshme.

Duhet theksuar që menaxhimi mjedisor është në interes të të gjithëve, kundrejt plotësimit të kërkesave. Duhet të zhillohet një menaxhim mjedisor i detajuar dhe një program trajnimi.

#### Të dhëna të përgjithshme

Shoqëria “ELBAGAS” sh.a. si firmë me aktivitet në fushën e veprimtarisë së “Prodhimit të Bioksidit të Sufurit SO<sub>2</sub>”, ka investuar dhe disponon impiantet/makineritë e domosdoshme për zhvillim e proceseve kryesore në prodhimin e produktit përfundimtar, sikurse janë përshkruar më sipër.

Perbërsit kryesorë të programit për menaxhimin e mjedisit ndërthuren si më poshtë:

- Informacion përgjithshëm;



- 
- Mirëkuptim i informacionit të përgjithshëm i konceptit të qëndrueshmërisë dhe arsyet për një menaxhim mjedisor të mirë;
  - Përdorimi i pajisjeve/aparatura të Certifikuara sipas Standartit European dhe Kolaudimi periodik i pajisjeve/aparaturave nga ekspertë të specializuar.
  - Respektimi i orareve të punës brenda zonës ku zhvillohet veprimitaria
  - Respektimi i masave teknike të punonjësve, sipas regullores së brendëshme.
  - Diferencimi dhe menaxhimi i mbetjeve të gjeneruara nga kompani të licensuara
  - Trajtim i ujrave teknologjike të gjeneruara nga instalimi
  - Kapja dhe trajtimi i gazrave të gjeneruar nga linja e prodhimit të bioksidit te squfurit SO<sub>2</sub>.
  - Zhurmat do të jenë të përkoshme dhe tepër të ulëta duke respektuar nivelin e lejuar të zhurmës, sipas Udhëzimit Nr.8, dt 27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara".
  - Mirëkuptimi i potencialit të ndikimeve ambientale, që mund të priten nga faza kryesore e zhvillimit të aktivitetit;
  - Funksionimi;
  - Arsyet për propozimin e masave zbutëse;
  - Vodosja në zinxhir e përgjegjësive dhe vendimarrja;
  - Trajnime specifike;
  - Monitorimi i cilësisë ajrit;
  - Monitorimi i cilësisë ujrave;
  - Kriteri për vodosjen e stacioneve monitoruese;
  - Metodologjitet që duhen përdorur përfushën e marrjes së mostrave;
  - Trajnime në përdorimin e pajisjes dhe teknikat korakte përuajtjen e mostrës;
  - Trajinim në laborator dhe rëndësia e cilësisë së sigurisë dhe metodat e kontrollit të cilësisë;
  - Trajinim në gjetjen e mospërputhjes së situatave dhe procedurat që duhen ndjekur;
  - Kërkesat e mjeteve që do t'ju kryhet shërbimi;

#### Plani i Përballimit të Emergjencave

Shoqëria "ELBAGAS" sha në veprimitarinë e saj, për aktivitetin e "Prodhimi të Bioksidit të Squfurit SO<sub>2</sub>", detyrohet të planifikojë, të organizojë dhe të realizojë me shpenzimet e veta dhe të shtetit shërbimet për përballimin e emergjencave civile në zonën ku zhvillohet veprimitaria.

#### Shoqëria ka për detyrë:

- Të hartojë plane për situatat e emergjencës civile dhe të zbatojë masat parandaluese në zonën e tyre të veprimitarisë.
- Të njoftojë personelin si dhe autoritetet e Njësisë Bashkiake Vendore për një rrezik imediat.
- Të organizojë, kur është e nevojshme, evakuimin e të punësuarve të tyre dhe të venë në veprim shërbimin e tyre në përgjigje të një situate emergjencë në zonën e tyre të veprimitarisë.
- Të ndërhyjë në mënyrë të menjëhershme në rast të dukurive natyrore apo emergjencave
- Të sigurojë trajnimin për të punësuarit.

Menaxhimi i prodhimit



---

Për mbrojtjen e instalimit nga bllokimi apo avaritë e ndryshme teknike rënia nën tension, rënia e zjarrit, bllokimi i impiantit/makinave nga papastërtitë e lëndës së pare, lëvizja e punonjësve dhe mjeteve të transportit të brendshëm, etj janë marrë këto masa:

- Përreth linjës së prodhimit të dioksidit të sqafurit ruhet distanca e sigurisë, e cila është vizuar me vijë të verdhë, përgjatë këtij perimetri lëvizin vetëm drejtuesit teknik (inxhinieri) të instalimeve dhe punonjësit e autorizuar
- Përcaktimi i vend-parkimit të automjeteve si dhe paisja e vend-parkimeve me sinjalistikën përkatëse.
- Brenda objektit kryhet menaxhimi i mbetjeve të ngurta,
- Mbetjet industriale të gjeneruara nga proceset e prodhimit të bioksidit të sqafurit depozitohen në sheshet e përcaktuara nga shoqëria brenda kushteve teknike per depozitim, magazinimin, transportimin dhe asgjësimin përfundimtar të tyre subjekte të licencuara.
- Lënda e parë magazinohet në ambientet e brendshme të objektit nga ku nëpërmjet makinerive të posaçme merret dhe dërgohet në proceset përkatëse, me qëllim "Prodhimin e Dioksidit të Sqafurit të Lëngët - SO<sub>2</sub>". Paisjet e reja janë më të avancuara dhe një sere veprimesh i kane te automatizuara duke shmangur kështu ndërhyrjen e punonjësve dhe të punuarit pranë tyre, përvëç të tjerash shoqëria ka disa rregulla strikte të cilat zbatohen me rigorozitet për mos ndërhyrjen në makineri gjatë punës, stakimit të energjisë para fillimit të kontrollit apo mirëmbajtjes e remontit të tyre, etj.
- Produkti përfundimtar, amabalazhohet në bombolat e tipit G, ku më pas dërgohet në destinacionin e kërkuar në varësi të kërkesës që shoqëritë e ndryshme kanë dhe në respektim të kushteve të kontratave që ato kanë lidhur me shoqerinë "ELBAGAS" sha.

### Plani i Monitorimeve Mjedisore

Monitorimi i burimeve natyrore, ajrit, ujit, tokës, shkarkimeve etj, kryhet sipas disa kriterieve shkencore përsa i përket vrojtimeve, mbledhjes dhe analizave të mostrave. Ai synon në mbledhjen e të dhënavëve për të vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror në ndryshimet e mjedisit, ku ai është aktiv.

Monitorimi i cilësisë së mjedisit mbetet një ndër çështjet parësore. Monitorim është procesi i zbulimit të ndryshimeve nëse do të ndodhin, përcaktimit të drejtimit dhe i matjes së shtrirjes së tyre.

Procesi i monitorimit do të përqëndrohet në të gjithë fazat e zhvillimit të projektit dhe fokusohet në aktivitet që gjenerojnë ndikime negative në mjedis në efektet e këtyre ndikimeve dhe në zbatimin e masave për zbutjen e tyre. Monitorimi do të kryhet nga vetë investori dhe në rast të pamundësisë teknike për realizimin e tyre do të kerkohet bashkëpunim i subjekteve të specializuara përfundimtar përkatëse. Verifikimi i monitorimit apo auditimit do të organizohet nga institucionet administrative si AKM-ja, Ministria e Mjedisit, ISHMP etj.

### - Kostot përkatëse të zbatimit të masave të propozuara për mbrojtjen e mjedisit

Preventivat e shpenzimeve të rehabilitimit

Ky lloj aktiviteti nuk përfshin impakte mjedisore në tokë dhe si rrjedhojë nuk ka detyrime/mundësi punimesh të rehabilitimit të tokës. Për këtë çështje nuk vlerësohen kostot dhe mundësi rehabilitimi mjedisit. Aktiviteti zhvillohet neë një zonë industriale të miratuar si të tillë dhe me infrastrukturën përkatëse.



- 
- Informacion për mënyrën e realizimit të konsultimit gjatë procesit të hartimit të reportit të thelluar të VNM-së dhe metodat e konsultimit, rezultatet përkatëse, kontaktet e personave dhe subjekteve që kanë marrë pjesë në këtë proces, mendimet që janë dhënë dhe arsyimet se si janë adresuar ose jo në reportin e thelluar të VNM-së, përfshirë edhe kërkesat e mendimet e dhëna në dëgjesën publike

Më datë 07.11.2016, ora 11-12<sup>00</sup>, dhe date 15.05.2017 u organizua dëgjesa publike për aktivitetin funksionimin e "Prodhimi i Dioksidit të Squfurit-SO<sub>2</sub>". (Procedurë e thelluar e VNM-së) kjo sipas shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, pika 6.b. "Prodhimi i kimikateve inorganike bazë", tësubjektit "ELBA GAS" sh.p.k, me kapacitet deri 500 kg SO<sub>2</sub>/orë. Subjektet që moren pjesë në këtë takim ishin ARMEbasan, subjektit private në afërsi të subjektit, pushteti lokal dhe disa banorëtë zonës.

Nga ana e pjesmarrësve nuk u ngritën probleme shqetësuese për aktivitetin dhe vendodhjen. U bënë pyetje lidhur me teknologjinë e përdorur, gjendjes së sistemit ekzistues, mjetet mbrojtëse që mund të përdoren në rast avarie etj.

Përgjigjet teknike u dhanë nga specialistja e cila kish hartuar dhe planin e emergjencave, ndërsa pyetjeve të tjera ju dhanë përgjigje nga administratori. Ai foli gjithashtu për punën qështë bërë deri tanë lidhur me problemet për minimizimin e problemeve mjedisore siç ishin: mirëmbajtja e sistemit të stohjes së rezervuareve të gazit dhe për çdo paisje, riqarkullimin e ujit që përdoret për nevoja teknologjike, gjelbërimin e mjediseve, pajisjen e punonjësve me rroba pune dhe mjetet mbrojtëse etj. Në përgjithesi nuk pati vërejtje.

Nga ana e specialistëve të ARM-së, u la detyrë pastrimi dhe sitemimi periodik i mjedisit të punës dhe të jashtëm të aktivitetit, mbajtjës në gadishmëri të sistemit të stohjes së rezervuarëve sidomos në periudhën e verës, zbatimi i kushteve të perçaktuara në planin e emergjencave dhe sigurimit teknik e zjarrit, zbatimi i Ligjit Nr. 10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" si dhe V.K.M.Nr.765, date 07.11.2012 "Per miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencajve dhe trajtimin e vajrave të përdorura", mbjellja e pemëve rrëth zonës etj. Njëkohësisht u trajtua problemi periodik i kryerjes së monitorimeve dhe informimi i AKM-së dhe ARM-së për kushtet që do të përcaktohen sipas Lejes Mjedisore si dhe raportimit për RGJM-në. Njëkohësisht nga ana e specialistëve të ARM u la detyrë rifreskimi dhe vodosja e tabelave të reja për mbrojtjen e mjedisit.

## Konkluzione

Nga verifikimi i mjedisit ku do të realizohet aktivitetipër "Prodhimin e Dioksidit të Squfurit të Lëngët - SO<sub>2</sub>" me kapacitet prodhues 500 kg/orëdhe të dhënavë që pasqyrohen në Raportin e Thellurit të VNM-së të veprimtarisë së mësipërme, rezulton se ushtrimi i këtij aktiviteti, bëhet konform të gjithave rregullave dhe ligjeve të përcaktuara. Ndikimi në mjedis është parashikuar dhe vlerësuar me objektivizëm në sipërsaqen që do të përdoret për kryerjen e aktivitetit prodhues



dhe përdorimit të teknologjisë së prodhimit të SO<sub>2</sub>. Bashkia Elbasan së bashku me ARM duhet të kontrollojë të gjithë proceset dhe monitorimet që do të kryejë investitori për aktivitetin prodhues.

Ndikimi në mjedisin e zonës gjatë aktivitetit për "Prodhimin e Dioksidit të Sufurit të Lëngët SO<sub>2</sub>" me kapacitet prodhues 500 kg/orë, është një ndikim që kërkon vëmendje dhe duhet monitoruar në çdo kohë, dhe shoqëria "ELBAGAS" sha, së bashku me organet e qeverisjes vendore, do të punojnë që ky ndikim të mbetet minimal, nën normat e kërkua, gjatë funksionimit të objektit industrial.

Pas përfundimit të projektit të zbatimit, si eksperte mjedis, në bashkëpunim me Ekspertin Mjedisor Yzeir Miraka, Ing. Mekanik Yllson Pëllumbi, dhe Znj. Donaldë Miraka, me kërkesë të investitorit hartova: **Raportin e Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për aktivitetin e "Prodhimit të Dioksidit të Sufurit të Lëngët - SO<sub>2</sub>", Njësia Administrative Bradashesh, Bashkia Elbasan për Shoqërinë "ELBAGAS" sh.a.**

Punuan Materialin



Eksperte mjedisore Ing. Lila Karaj

Eksperte mjedisore Ing. Gjeolog Yzeir Miraka

Ing. Mekanik Yllson Pëllumbi

Teknolloge Ushqimore Donaldë Miraka

dhe përdorimit të teknologjisë së prodhimit të SO<sub>2</sub>. Bashkia Elbasan së bashku me ARM duhet të kontrollojë të gjithë proceset dhe monitorimet që do të kryejë investitori për aktivitetin prodhues.

Ndikimi në mjedisin e zonës gjatëaktivitetit për "Prodhimin e Dioksidit të Squfurit të Lëngët SO<sub>2</sub>" me kapacitet prodhues 500 kg/orë, është një ndikim që kërkon vëmendje dhe duhet monitoruar në çdo kohë, dhe shoqëria "ELBAGAS" sha, së bashku me organet e qeverisjes vendore, do të punojnë që ky ndikim të mbetet minimal, nën normat e kërkua, gjatë funksionimit të objektit industrial.

Pas përfundimit të projektit të zbatimit, si eksperte mjedis, në bashkëpunim me Ekspertin Mjedor Yzeir Miraka, Ing. Mekanik Yllson Pëllumbi, dhe Znj. Donalda Miraka, me kërkesë të investitorit hartova: **Raportin e Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për aktivitetin e "Prodhimit të Dioksidit të Squfurit të Lëngët - SO<sub>2</sub>", Njësia Administrative Bradashesh, Bashkia Elbasan për Shoqërinë "ELBAGAS" sh.a.**

Punuan Materialin

Eksperte mjedisore Ing. Lila Karaj



Eksperte mjedisore Ing. Gjeolog Yzeir Miraka



Ing. Mekanik Yllson Pëllumbi

Teknolloge Ushqimore Donalda Miraka

Ing. Agromjedisë Ervis Pervana